

Takimi i Antarëve të Bordit EITI | MINUTES

Data e takimit | Ora 6/Maj/2016 11:00 AM | Vendtakimi MEI

Takim i thirrur nga
Sekretariati Shqiptar
EITI

Të pranishmit

Anetarë të MSG-së

Z. Ilir Bejtja, Kryetari MSG

Z. Dritan Spahiu, MEI

Z. Azbi Arapi, AKBN

Z. Mehmet Hasalami, MEI

Z. Bilal Koçi, SHGJSH

Z. Përparim Alikaj, FIAA

Znj. Laura Cela, Benkers Petroleum

Z. Sami Nezaj, ShC

Znj. Anila Hajnaj, ShC

Z. Ilir Aliaj, ShC

Znj. Madlina Puka, ShC

Të tjerë

Znj. Dorina Çinari, Albania EITI

Z. Agim Shehu, Albania EITI

Znj. Arlinda Rumbullaku, Albania EITI

Znj. Emiliana Kola, Albania EITI

Znj. Eni Bajraktari Albania EITI

Znj. Anisa Deda Albania EITI

Z. Lluka Gjergo, Albania EITI

Z. Neza:Kërkime shkencore, konferencë shkencore, konferencë për problemet e komunikimit dhe shpërndarjes së mesazhit. Bashkëpunim me mediat, transmetimin me mediat dmth lidhur me këtë çështje. Jo të dedikuara, ta zëmë Wake Up fton dy prej këtyre personave të cilët e kishin vënë në konferencë apo e kishin vënë në projekt apo në program dhe flisnin për këtë gjë. Unë di që dixhitalizimin në Shqipëri nuk e njihnte kurkush përpara. E njihnim vetëm në që merreshim me këtë dhe të tjerët nuk e njihnin. Më pas u bë një gjë popullore dhe sot unë e shoh kur bëhen fushata apo takime, njerëzit janë shumë konfident dhe të njohur me këtë. Kjo ndodh për dy arsye, së pari se ata janë mjeshtra të komunikimit dhe kanë akses shumë në media. Kanë një akses që e realizojnë shumë më lehtë se secili prej nesh. Për shkak se ata i kanë studentë, një pjesë e tyre kanë qënë studentë dhe shfrytëzojnë në një farë mënyre edhe lidhjet. Tjetra është që njohin teknikat e komunikimit dhe vinë nga Gjeografi të ndryshme e cila ne na intereson, se nuk na intereson të flasim vetëm në Tiranë apo të bisedojmë vetëm në Tiranë për këtë gjë. Ne nëpërmjet atij komuniteti studentësh dhe pedagogësh mund të flasim edhe në Bulqizë, edhe në Fier, edhe në Patos, edhe në Pogradec, edhe në Tropojë sepse i përkasin komuniteteve të ndryshme.

Znj. Çinari: Unë e lexova propozimin dhe më duket aktivitet shumë i mirë.

Z.Bejtja: Fiks fare është

Znj. Çinari: Po po, por duhet të ketë një koncept që ta fusësh në plan pune.

Z.Bejtja: Ok uluni dhe formuloni një propozim.

Z. Neza: Konceptin për dy ditë mund të ta sjellin ata kanë skuadër që punon për këto gjëra dmth. Ata kanë dhe përvoja, nuk është kjo përvoja e parë. Ata kanë edhe përvoja me Bashkimin Evropian, me institucione dhe me fondacione Gjermane kanë punuar me një projekt afatgjatë tre vjeçar.

Z.Bejtja: Sami, nëqoftëse ata do të vinë, le të zgjasin dhe dy-tre ditë më shumë, ta komplotojnë dhe me aktivitete, të bëjnë dhe një listë buxheti, ta bëjnë të plotë dhe e fusim në listë.

Z. Neza: Besoj se pastaj ato problemet e kontratave ju e dini vetë sesi janë, ata janë institucion publik nuk janë privat.

Znj. Çinari: Do e gjejmë mënyrën, e rëndësishme është të arrijmë një aktivitet të bukur. Anila edhe juve keni një propozim, apo jo?

Znj. Hajnaj: Jo neve kemi atë propozimin e atij shadow report që kemi thënë.

Znj. Çinari: Është pjesa e outreach apo e ndonjë objektivi tjetër?

Znj. Hajnaj: Jo kjo është pjesë e investigimit për çështje që nuk i mbulon raporti dhe veçanërisht kjo pjesa e rentës që duam ti shkojmë më në thellësi dhe pjesa e projekteve sociale ose të mjedisit, ku kanë shkuar, çfarë projektsh janë realizua, si janë realizuar etj.

Z.Bejtja: Tip monitorimi.

Znj. Hajnaj: Po, tip monitorimi. Dhe mendoj që ne si koalicion i shoqërive civile mund ta bëjmë këtë gjë, pa hyrë në këtë buxhetin e Bankës Botërore e cila na pengon dhe kërkojmë nëqoftëse ne mund të shkojmë edhe me një përfaqësues.

Z.Bejtja: Edhe në punën e buxhetit ne mund të gjejmë rrugën taktikisht.

Znj. Çinari: Mund të gjejmë dehe partner të tjerë...

Z.Bejtja: Do gjejmë një organizatë që nuk hyn në konflikt me ne. Një partner i cili nuk hyn në konflikt.

Znj. Hajnaj: Thjesht do të donim letër mbështetje nga Sekretariati dhe MSG që neve meqënëse jemi të tërë ekspertët e kësaj gjëje ti shkojmë ti hyjmë thellësi dhe besoj se do nxjerrim një gjë shumë të mirë.

Z.Bejtja: Shumë dakort

Znj. Hajnaj: Unë këtë gjë e propozova edhe kur ishim në Peru. Ju a thashë dhe atyre të Publish What You Pay dhe e pëlqyen jashtëzakonisht si projekt dhe menduan që do jetë një projekt pilot i cili mund të jetë shembull në të gjithë botën.

Znj. Çinari: Edhe mua më duket shumë i mire. A mund të kemi edhe nga ju një koncept të shkurtër që ta përfshijmë në kalendarin e aktiviteteve?

Znj. Hajnaj: Unë po punoj me projektin dhe do ta ndaj me kolegët që ta aprovojnë dhe mund të shtojmë dhe pastaj mundet që të vemi dhe bashkë dhe nuk e di, pasi Dorina ka propozuar që do më asistoj mua në vajtjen nëpër ambasada ose kudo që të jetë.

Znj. Çinari: Do ti gjejme partnerët.

Znj. Hajnaj: Ne këtë kërkojmë dhe mendojmë që Shqipëria mund të jetë shumë avangardë në këtë çështje në gjithë botën dhe një shembull për këtë gjë.

Z.Bejtja: Shumë dakort.

Znj. Çinari: A keni ndonjë propozim tjetër në kuadër të planit të këtij viti? Ndonjë gjë që e shikoni me shumë interes?

Z.Bejtja: Më mirë të bëjmë një strukturim të programit që tja vëmë të gjithëve në dispozicion

Znj. Puka: E kemi! E kemi marrë ne.

Z.Bejtja: Për outreach.

Znj. Puka: Outreach është i vendosur dhe është 35 mijë euro.

Znj. Çinari: Dakort, por nëse ka konkretisht ndonjë propozim?

Znj. Puka: Unë pëlqej atë idenë e sepse është shumë e kompletuar?

Znj. Çinari: Idenë e Samiut?

Znj. Puka: Po.

Znj. Çinari: Edhe mua më pëlqen shumë

Znj. Puka: ...që ta përdorin edhe ata si ushqim për më tepër, për të bërë dhe emisionet në media?

Z.Bejtja: Ne si Ministri po mundohemi ta përdorim AlBEITI-n, në pozicion koordinatori, ta fusi Shqipërinë siç jemi në energjinë elektrike, edhe në gas dhe naftë, në industrinë nxjerrëse kryesisht, si prioritet për zonën e rajonit për mbështetjen e investimeve. Përshembull ne kemi

marrë për energjinë elektrike deri tani nga Banka Botërore dhe KPV rreth 530 milion euro, që janë investime për sektorin. Kuptohet këto nuk kanë ardhur në boshllëk. Janë bërë më përpara kërkesë- projekte, studime fizibiliteti. Në bazën e këtyre ne kemi çuar një kërkesë në Bankën Botërore në formë list prioritetesh. Tani ato vijnë në Qershor për një vizitë. Do flasim edhe me Ministrin dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe Ministrinë e Financave dhe do i konkretizojmë pak më tepër, jo listë e gjatë ato detajet që ne duam të theksojmë, çfarë ne do kërkojmë dhe mbi bazën e atyre pastaj do kërkojmë të kemi mbështetje dhe asistencë për përgatitjen e studimeve përkatëse për ti hapur rrugën nesër pasnesër investimeve në sektor. Në këtë formë ne mendojmë ta përfshijmë goxha AlBEITI-n, jo thjesht monitorues por edhe menaxherin e gjithë këtij procesi. Nuk e di çfarë mund të vine në terma financiarë por besoj nja 2 milion \$ do të ishte si fillim, pra për mbështetje, për studime e të tjera me radhë që janë jashtë objektivit që lidhen me raportimet por lidhen me studime...që unë do e vlerësoja shumë nëse edhe ju do ishit pjesë të gjithë kësaj përgatitje, pra kështu e mendojmë.

Z.Aliaj: Më falni për vonesën.

Z.Bejtja: Ska gjë. Gjithësesi, pasi të kemi mbaruar takimin me ata ndoshta do zhvillojmë një takim jashtë radhe të MSG-së dhe flasim më konkretisht.

Znj. Çinari: Shumë mirë.

Z. Bejtja: Për mbledhjen e sotme e keni axhendën dhe duhet të miratojmë sa më shpejt të jetë e mundur termat e references që të hapim garën për raportimin. Dhe nëqoftëse kemi edhe ndonjë gjë tjetër për të diskutuar rreth programit të punës.

Z.Aliaj: Kam unë një merak, meqënëse nuk u përmend më duket. Ndoshta jam me vonesë edhe nuk e kam kapur që nga fillimi. Ka ardhur një draft rregullore për MSG-në.

Z.Bejtja: Këto janë Termat e Referencës.

Z. Aliaj: Përveç Termave të Referencës ka ardhur dhe një draft rregulloreje. Do diskutohet sot apo jo?

Z. Bejtja: Po.

Znj. Çinari: Prioritet për ne është miratimi i Termave të Referencës.

Z. Bejtja: Së pari thashë të kalonim Termat e Referencës.

Z. Aliaj: Mendova mos janë hequr nga diskutimi, ska asnjë problem...

Z. Bejtja: Jo jo asgjë nuk është hequr.

Znj. Çinari: Këto janë Termat Standarte sipas standartit të ri që është miratuar në Nima. Dokumenti është marrë me aprovim nga EITI në Oslo. Pra ata e kanë lënë të lirë, thonë që për ne është sipas formatit të kërkuar vetëm nëse MSG-ja ka komentet e veta që lëvizin nga ky dokument. Ne kemi shtuar në raport edhe kërkesat që kemi pasur vjet lidhur me ...natyrisht por edhe kërkesave të tjera që i përkasin informacionit kontekstual. Një pikë e cila duhet të diskutojmë është sesi duhet të qasemi, ju si shoqëri civile besoj se keni më shumë interes, është tema pjesë e EITI-t është Beneficiary Ownership. Si do ta trajtojmë në këtë raport çfarë do shkruajmë dhe kush është kërkesa e kësaj MSG-je?

Z. Bejtja: Kjo pjesa e Beneficiary Ownership ka të bëjë me të drejtën për të qënë shumë diskret me disa informacione ose me detyrimet. Kërkesa nga EITI është shumë e fortë që të thellohet akoma më tepër Transparenca lidhur me Beneficiary Ownership. Sidomos në kompanitë të cilat operojnë në industrinë nxjerrëse. Pra duhet të dimë cilat janë burimet që mbështesin biznesin e tyre. Ku shkojnë përfitimet nga biznesi i tyre, në kuptimin e ndarjes së fitimit ose të dividendeve, gjë e cila rregullohet edhe nga legjislacioni Shqiptar për privacy-në e disbursimit të të dhënave. Besoj se kjo do kërkoj ca implikime nëqoftëse ne duhet ta thellojmë në legjislacionin bazë sidomos kur bëhet fjalë për industrinë nxjerrëse kryesisht në zonat e naftës ku çdo marrëveshje hidrokarbure ka disa klauzola që u japin të drejtë operatorëve të mos bëjnë transparente çdo pjesë të aktivitetit të tyre sidomos kur bëhet fjalë për ndarjen e dividendëve, kush janë përfituesit. Nga ana tjetër historitë që kemi pasur së fundmi, presioni i madh në rritje lidhur me nga vjen ky investitor, shumë prezencë e kompanive offshore me investime në industrinë e naftës. Ndonjëherë dhe jemi të detyruar ti pranojmë se nuk ka oferta të tjera, janë edhe ata prezent në treg edhe na shtyn që ta thellojmë këtë transparencë. Nuk e di nëse do ishte e mundur nëse ju do kishit propozime konkrete se si mund të bëhej një gjë e tillë.

Znj. Çinari: Të paktën në kuadër të raportit 2015.

- Z. Aliaj:** Janë dy çështje. E para duhet të ishte bërë paraprakisht një studim.
- Z. Bejtja:** Për Beneficiary Ownership?
- Z. Aliaj:** Po, për të parë se si është situata në Shqipëri?
- Znj. Çinari:** Kjo është një ngjarje e shkurtit, temë e re.
- Z. Bejtja:** Ka dalë tani si kërkesë.
- Z. Aliaj:** Po sikur ka qënë edhe më përpara, tani është forcuar kërkesa.
- Znj. Çinari:** Jo tani është e standartizuar.
- Z. Bejtja:** Një sekond të lutem.
- Z. Aliaj:** E para kjo, duhet të ishte bërë një dhe nëse ka kohë edhe mund të bëhet një tani.
- Z. Bejtja:** Ky është problem.
- Z. Aliaj:** Dhe e dyta është kur flasim për offshore.
- Z. Bejtja:** Po.
- Z. Aliaj:** A njihen nga legjislacionet ndërkombëtare?
- Z. Bejtja:** Natyrisht që njihen.
- Z. Aliaj:** Sepse pjesa më e madhe e kompanive që operojnë në Shqipëri sidomos në fushën e naftës, Dritani besoj e di më mirë janë nga Cayman Island ose Virgin Island.
- Z. Bejtja:** Nuk është ashtu. Një pjesë e mirë janë goxha transparente, Shell nuk është ashtu, Bankers nuk është ashtu...
- Z. Aliaj:** Deri sa njihen në legjislacionin ndërkombëtar... Bankers është në Virgin Island.
- Z. Bejtja:** Prapë është e regjistruar edhe në bursë.
- Z. Aliaj:** Po në bursë po por paratë?

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Z. Alikaj: Absolutisht nuk i paragjykon dot!

Z. Bejtja: Unë nuk thashë që është gabim që janë të regjistruara në parajsa fiskale. Nuk e kam aty është gabim apo jo, përderisa janë shtete të pavaruara kanë të drejtë të regjistrojnë kompani njëloj siç regjistrohen edhe tek neve. Çështja është që sa janë ato të detyruara të disbursojnë informacionin për publikun. Neve tani nuk kemi pse i referohemi legjislacionit bazë që kanë kompanitë atje ku janë themeluar. Duhet ti referohemi më mirë legjislacionit tonë këtu. Sesi ne mund ta rrisim ne këtë detyrim.

....

Z. Aliaj: Epo sështë Beneficiary Ownership atëhere sepse këtu i ka të hapura të gjitha letrat ai.

Z. Bejtja: Jo si ka të hapura.

Z. Alikaj: Ti ke të drejtë të kërkosh burimin e parave të kompanisë.

Z. Aliaj: I ka të hapura në Shqipëri letrat se është i regjistruar normalisht.

Znj. Hajnaj: Në QKR mund të merrni informacionin.

Z. Aliaj: Bankers Albania e ka të shkruar edhe operon me bankat Shqiptare dhe nuk mundet që bankat Shqiptare e kanë kështu...

Z. Neza: Synimi i këtij Standarti nuk është hapi parë është ajo çfarë nuk shihet.

Z. Aliaj: Po si do e gjesh pra? Unë këtë po them...

Z. Bejtja: Mund ta gjesh me detyrimin në legjislacion. Nëse ti i vendos detyrim në legjislacion, prandaj thashë nëse ne nxjerrim se çfarë ndryshimesh duhet të bëjmë në legjislacion mundet këto ti propozojmë për miratim.

Z. Alikaj: Më falni unë them që të mos e shpikim rrotën. Franca, Anglia, Suedia, Amerika çfarë kanë bërë?

Znj. Çinari: Kanë filluar njësoj si ne.

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Z. Alikaj: Të mos ndajmë dy gjëra që të jenë matanë kësaj, as poshtë por të jemi atje ku janë këto vënde.

Z. Bejtja: Përderisa ne e kemi si kërkesë raportimi edhe Beneficiary Ownership, nesër do dalim me një paragraf ku kemi mundësi të raportojmë se si shpërndahen dividendët, përfitimet për shareholders, nuk mund ta themi këtë.

Z. Aliaj: Më fal por nuk është kjo Beneficiary Ownership.

Z. Bejtja: Është si nuk është?

Z. Aliaj: Jo jo kjo është vetëm një pjesë. Sepse po marr Bankersin kot, më fal.

Znj. Cela: Jo mos e merr fare...

Z. Aliaj: Mirë kompania e Ilirit, se nuk ka rëndësi. Një kompani X këtë e jep në fund të vitit. E bën raportin e fundit dhe thotë kaq para është fitimi, kaq para kanë shkuar tek shareholderat dhe kaq para janë mbajtur për problemet operative të kompanisë.

Z. Bejtja: Cilët janë përfituesit nominativë.

Znj. Hajnaj: Po pra kjo duhet kërkuar.

Z. Bejtja: Këtë po them edhe unë.

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Z. Aliaj: Është e regjistruar kompania diku tjetër jo në Shqipëri.

Z. Spahiu: Për sa i përket naftës, legjislacioni është shumë i qartë kur ti lidh një marrëveshje me një kompani, për të shmangur keqkuptimet a duhet të jetë...apo sduhet të jetë. Jam dakort me Përparimin, mjafton që ajo të plotësoj kriterin teknik dhe financiar dhe është e aftë për të kryer operacionet... je i detyruar por do lidhësh marrëveshje hidrokarbure. Ndërsa lidhur me shqetësimin për standartin me ligjin 7746 të prodhimit të naftës ne kemi vendosur një kusht, vjet dhe kemi thënë që kompanitë janë të detyruara të raportojnë sipas standartit EITI. Nga momenti

që ti këtë standart e miraton në MSG, unë nuk shoh ndonjë problem për kompanitë që të raportojnë.

Znj. Hajnaj: Problemi është këtu, të merret vesh sepse ne edhe e kemi diskutuar në gjithë seminarët dhe workshopet që kemi zhvilluar. Transparenca për të ditur kush përfiton. Nëse ti e ke nga QKR se kush është këtu, duhet të dihet se kush është atje në Cayman Island apo ku do që të jetë. Ka ndonjë Shqiptar që mund të jetë lider, që mund të jetë politikan, i përfshirë dhe ka edhe ai share-in andej. Le ti bëjmë transparente. Kjo është gjithë ideja kjo është kush është pronari i vërtet, Beneficiary Ownership. Kush përfiton realisht nga këto kontrata.

Znj. Çela: Ata janë me mijëra aksioner.

Znj. Hajnaj: Po le të jenë aksioner.

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Z. Arapi: ...ai është standart ndërkombëtar njëherë dhe ata përfitojnë siç ka përfituar Zvicra për mbajtjen e të hollave, ka përfituar edhe Malta, Luksemburgu, Qiproja.

Z. Bejtja: Po ne nuk jemi kundra kësaj Azbi.

Z. Arapi: Prisni ta mbaroj, në Offshore ai shkon me dy standarte. Standarti parë, një sepse ka taksat e ulëta...

Znj. Hajnaj: Po le ti kenë...

Z. Arapi: ...dhe së dyti mban enigmatik aksionerin

Znj. Hajnaj: Kjo pra duhet kërkuar.

Z. Arapi: Kjo nuk kërkohet dhe nuk besoj se e ka MSG këtë tagër?

Z. Aliaj: Nuk mund ta kërkosh, harroje!

Znj. Hajnaj: Pse s'duhet ta kërkoj? Po gjithë qëllimi i EITI-t ky është që ta gjej kush është Beneficiary Ownership.

Z. Bejtja: Detyrimi ynë është, njëherë e para të ndjekim procedurat, të bëjmë kërkesat. Nëse ne do të gjejmë rrugën ta mbështesim këtë edhe në legjislacionin Shqiptar, ky është sukses për ne, nuk është problem.

Z. Neza: Shumë mire do ishte.

Z. Aliaj: Nuk kam asgjë kundra kësaj por duhet të jemi realist. Kur kanë dalë vajzat e Alievit, Presidentit të Azerbaixhanit që janë mbrapa disa kompanive që operojnë në Azerbajxhan, është bërë një investigim prej 6 vjetësh. Personat që kanë bërë investigimin kanë rrezikuar jetën.

Z. Bejtja: Mund ta nisim dhe neve këtë.

Z. Aliaj: Më fal të lutem ta mbaroj si diskutim dhe përsëri gjërat nuk janë krejt të qarta.

Z. Bejtja: Ne nuk jemi te Alievi, rri i qetë. Alievi është si në kohë të Mao Ce Dunit.

Znj. Hajnaj: Unë dhe ti mund të kemi një kompani që mund të jemi dhe shareholdera në ato ishuj. Të merret vesh që jemi dhe ne të dy atje dhe kaq.

Z. Aliaj: Shko gjeje pra!

Z. Bejtja: Nëse të detyron ligji do jetë me auto detyrim!

Znj. Puka: Tani me sa kuptoj këto janë çështje të standarteve të reja të EITI dhe ne si shtet duhet ti përshtasim sipas legjislacionit tonë të gjitha.

Z. Bejtja: Të EITI, siç kemi bërë me të gjitha.

Z. Aliaj: Më falni, unë në parim nuk jam kundra...

Z. Bejtja: Shumë mirë, këtu rri.

Z. Aliaj: Por për vështirësitë e realizimit.

Z. Bejtja: Një sekondë, ne nuk e dinim që do ndryshonim formulën e rentës në shpërndarje, nuk e dinim as që do fillonim të ndryshonim rentën minerare dhe do të fillonim të ndërhyjmë tani te paketa fiskale dhe ligji. Gjërat ndodhin, nuk është se nuk ndodhin. Përderisa ekziston shqetësimi,

lind shqetësimi, dhe në këtë rast ne kemi një shqetësim se është një standart i cili shumë shpejt do jetë i detyrueshëm për zbatim për të gjitha vendet antare, ne duhet të marrim masat që tani që të fillojmë me përgatitjen.

Znj. Hajnaj: Edhe standarti nuk është vendosur kot. Standarti është konsultuar edhe neve jemi konsultuar, a jeni dakort, sa jeni dakort, 100% që të hyjmë në kërkim apo pjesërisht? Të gjithë kemi marrë pjesë dhe kemi dhënë mendimin, prandaj është vendosur standarti.

Z. Neza: Në konferencën ndërkombëtare të EITI-t, një seksion i tërë ishte vetëm për beneficiary ownership, pothuajse një ditë dhe mua më duket normal ky studimi i Legjislacionit.

Znj. Hajnaj: Po ishte për Beneficiary Ownership dhe prandaj u vendos standarti.

Z. Bejtja: Nejse, unë mendoj që kjo të jetë pjesë e Termave të Referencës pastaj duhet të propozohen masat që duhen marrë.

Z. Alikaj: Më falni kompanitë që janë të regjistruara nëpër bursa ...

Z. Bejtja: Hera e parë do jetë me vetdeklarim.

Z. Alikaj: Po. Në kompanitë që janë të regjistruara në bursat e Torontos, New York, Londrës dhe të gjitha me radhë, e kanë që çdo aksioner aty, që ka blerë aksione dhe nuk ka rëndësi nëse kompania është e regjistruar atje .. sepse aty kanë mbaruar punën. Mban përgjegjësi shteti i bursës.

Z. Bejtja: Kur janë të kuotuar në bursë. Por kur nuk janë?

Z. Alikaj: Kur janë private dhe nuk janë të kuotuar në bursë.

Z. Bejtja: Është me vetdeklarim.

Z. Alikaj: Po, prra shumica e kompanive janë të regjistruara këtu tek ne.

Z. Bejtja: Ne do ta fillojmë dhe më pas do shikojmë dhe çfarë problemesh kemi për ta menduar se si do gjejmë një rrugë. Gjërat fillojnë të ndodhin sepse fillojnë disa procedura dhe shqyr që ka ardhur një orientim ndërkombëtar dhe ne vdesim për orientime ndërkombëtare, nuk jemi të zotë ti nisim këto gjëra vetë dhe të fillojmë të marrim masa që këto nesër, pasnesër të

transmetohen edhe në kuadrin ligjor që neve kemi për industrinë nxjerrëse. Ndonjë koment tjetër? Dmth jeni dakort me këto terma kështu si siç janë.

Znj. Puka: Janë edhe këto termat e referencës të tjera që janë për kuadrin ligjor. Kështu që kjo sapo thamë mund të ndihmoj.

Znj. Çinari: Mund të shtohet edhe aty.

Znj. Puka: Po, te Termat e Referencës të kuadrit ligjor që të gjendet ndonjë mundësi apo propozime për Beneficiary Ownership dhe bën një rrugë dhe dy punë.

Znj. Hajnaj: Jo, Iliri propozoi një projekt këtë gjë dhe ndoshta mund të bëhet një projekt, një raport dhe të përfshihen disa njerëz.

Z. Bejtja: Pse jo?

Znj. Hajnaj: Si studim dmth...

Z. Bejtja: E fusim tek ky programi që unë ju thashë për industrinë nxjerrëse.

Znj. Hajnaj: Shumë mirë.

Z. Bejtja: Me financim të Bankës Botërore.

Znj. Çinari: Çfarë do kemi, çfarë do studiojmë?

Z. Bejtja: Një studim të situatës.

Z. Aliaj: Duhet të kemi një studim të situatës në Shqipëri, se të gjitha mund të jenë të regjistruara në vendet që nuk janë offshore dhe nuk ka nevojë që të merremi me to.

Znj. Çinari: Ke kompani Shqiptare, nuk flitet vetëm për offshore.

Z. Aliaj: Prisni ta mbaroj. Mund të jenë të gjitha kompanitë në rregull dhe janë deklaruar njerëzit që janë mbrapa dhe ne e kemi shumë më të thjeshtë historinë.

Z. Bejtja: I merr më tepër pikë.

Z. Aliaj: Po.

Z. Bejtja: Një mapping të gjithë kompanive që kemi dhe kjo me full background.

Znj. Puka: Po pra, më mirë mapping sesa fjala studim.

Z. Aliaj: Nuk mund të bëjmë rekomandime për amendime legjislacioni kur ne i kemi gjërat në rregull. Ne ta shohim njëherë se si e kemi situatën sepse nuk e dimë akoma.

Z. Bejtja: Studimi edhe i anës ligjore. Së pari, evidentimi i komplet i kompanive me profil të plotë dhe e dyta studimi i aspekteve ligjore.

Znj. Hajnaj: Rekomandimet duhet të jenë.

Znj. Puka: Ok, por ne i kemi aktualisht Termat e Referencës që thonë shqyrtimi ligjor dhe rregullator i kuadrit legjislativ kombëtar Shqiptar për të evidentuar pengesa, ngandalësime në mbledhjen e të dhënave të procesit EITI, për agjenci shtetërore, operatorë.

Z. Bejtja: Që të jenë pjesë e raportimit.

Znj. Puka: Kështu që ne e kemi aktualisht anën ligjore dhe nuk kemi pse bëjmë dublim dhe të fondeve kurse një mapping që të ishte një gjë paraprake dhe tua jepje këtyre gati, vetëm beneficiary ownership mund të ishte një gjë shumë e mirë.

Z. Aliaj: Një minutë, se nëse bëjmë këtë ushtrimin dhe na rezulton që 50% nuk janë shumë të qarta, atëherë do të na duhet për të propozuar ndryshime në legjislacion.

Z. Bejtja: Po po, edhe në raport do ta bësh një gjë të tillë.

Znj. Puka: Se kjo është shumë e qartë që ne tani kërkojmë gjëra të reja të paktën në kuadrin ligjor edhe propozime se besoj nuk do bëjnë thjesht gjetje, por do bëjnë edhe rekomandime.

Znj. Çinari: Aty është edhe ideja.

Znj. Puka: Sepse është konsulencë ndërkombëtare dhe lokale...

Z. Arapi: Në QKR është vetëm një regjistrim dhe në një noter publik ka bërë 500 marrveshje të tjera që ne nuk dimë gjë dhe nuk do e kapim asnjëherë.

Z. Arapi: Në QKR është vetëm 100% të aksioneve, qarkullojnë dhe 100 milion dollar në vit, ka dhe kapitalin në QKR, 100 mijë lek të reja të aksioneve dhe ky është spektakli televiziv.

Z. Bejtja: Azbi, do kryqëzosh infomacionin siç e bën në raportim ku ti e merr nga burime të ndryshme, nuk do ja gjejmë ne zgjidhjen.

Z. Neza: Ne nuk do e zgjidhim sot. Ne kemi inicuar një proces.

Znj. Çinari: Ky është inicim i procesit.

Z. Bejtja: Ky do jetë një program që nesër pasnesër do jetë i detyrueshëm për të gjithë sektorët.

Z. Arapi: I gjithë problem është që të iniciojmë diçka duhet të shohim dhe mundësinë e implementimit se është e kollajshme nesër ti thuash zotit Mehmet, që urdhëro merre tani dhe zbatoje. A ke bërë një studim fizibiliteti për këtë punë sesi do të implementohet.

Z. Bejtja: Azbi një profilizim për të gjithë industrisë ne mund ta bëjmë. Një profilizim total mund ta bëjmë dhe s'na prish asnjë lloj gjëje, përkundrazi na ndihmon. Ju duhet ta kishit bërë me kohë si AKBN, që do bënit dixhitalizimin, ka mbaruar ai?

Z. Arapi: Akoma jo, në proces finalizimi është.

Z. Bejtja: Edhe ai është një burim tjetër informacioni i rëndësishëm. Kështu që ka mundësi të bëhet.

Z. Alikaj: Tani që ke rregullore të ligjit minerar do dali që kompania duhet ta ketë këtë, atë gjë.

Znj. Çinari: Prandaj kemi termat e tjera të referencës dhe ai është gjithë qëllimi i atyre që gjithë boshlliqet ligjore të zbardhen.

Z. Alikaj: Po dhe pastaj ti e vendos vetë, ja jep apo nuk ja jep lejen. Kjo është gjëja më e mirë.

Znj. Puka: Është gjëja më e mirë të rishikohen gjithë marrveshjet kontraktuale.

Znj. Çinari: Në thelb të nevojës së beneficiary ownership është të shikohen lidhjet politike. Nuk është a ka regjistruar ai në QKR apo jo, por kush është pronari dhe kush është mbas këtij pronari.

Z. Bejtja: Ju lutem mund të ecim tek pika tjetër?

Znj. Çinari: Ky është qëllimi, jo kush janë pronarët e regjistruar. Qëllimi është të zbardhen interesat politike. Vazhdojmë te termat e referencës për rishikimin ligjor. Nuk e di a e keni konsultuar dhe a keni ndonjë koment për këto. Nga të gjitha raportet që kemi prodhuar deri tani, ju jeni informuar se keni qënë pjesë e procesit që kemi hasur vazhdimisht vështirësi që lidhen me pengesa ligjore, me paqartësi institucionale, me kompani që nuk e quatin si detyrim që të raportojnë, me forma raportimi që nuk kuadrojnë, me institucione që mbajnë formate të ndryshme dhe nuk jemi në gjëndje ti konvergjojmë. Dhe këto terma e reference synojnë një shërbim konsulence i cili ti shohi të gjitha këto problematika dhe të draftojë rishikime ligjore, rregullore, VKM sipas nevojës por kjo do vijë në fund të një skanimi që do përmirësojë këtë proces dhe ta bëjë më të qëndrueshëm, që ne të mos vuajmë çdo vit të njëjtën problematikë. Pra AKBN-ja ta dijë se kush do jenë informacionet që do përgatisin në fillim të çdo viti, Ministria e Energjisë të dijë informacionin e vetë, ky informacion përgatitet me një standart. Kompanitë kanë një detyrim të caktuar i cili rregullohet me ligj. Ka edhe penalitete nëse nuk raportojnë, pra vinë bashkë. Këtu mund të shtojmë edhe beneficiary ownership ashtu siç e sygjerau ju. Unë e kam listuar por mund ta themi më mirë. Mund ta formulojmë që tani se si e doni të shkruhet këtu, meqënëse i kishit idetë. Faqja e tretë, nën pikën, dmth sipër kontrata dhe objektivat e saj është publikimi i përfituesve dhe pronarëve të vertet.

Znj. Puka: Këtë mund ta shtosh tek pika a, tek kontrata që ka komponentët e mëposhtëm, tek shqyrtimi diagnostikues, identifikim pengesash apo edhe arsye të tjera dhe tek mbledhjet e të dhënave përfshirë dhe publikimin e përfituesve të pronarëve të vërtet që të marri pak më shumë theks në këtë.

Z. Bejtja: Ta heqësh nga aty ku është?

Znj. Puka: Jo, aty le të rrijë.

Z. Aliaj Me sa unë jam në dijëni, zotërinjtë Hasanlami, Dritani dhe Azbiu mund ta thonë më mirë por mesa jam unë në dijëni Legjislacioni Shqiptar e ka shumë të qartë të parashikuar mënyrën e raportimit, pra sipas ligjit minerar ashtu edhe për industrinë e naftës dhe të gazit dhe tek AKBN mesa jam unë në dijëni, më korigjoni nëse jam gabim, ka një database shumë të rregullt, nëqoftëse nuk raportohet çdo tre muaj ...

Z. Bejtja: Penalizohet.

Z. Aliaj: Penalizohet dhe mua më duket e gjitha kjo diçka që ne nuk na kërkohet shumë sepse nëqoftëse një kompani nuk raporton dhe ne me zotën Hansanlami e kemi diskutuar këtu edhe vjet, kur ishin nja dy a tre kompani që nuk raportonin dhe me sa kujtoj unë, mund të jem edhe i gabuar, zotëria ka thënë që unë do marr masë ndaj tyre.

Z. Hasanlami: Ne kemi marrë masa direkt.

Z. Bejtja: E merr institucioni vetë.

Z. Hasanlami: Institucioni bazuar në ligjin minerar automatikisht...

Z. Aliaj: Dhe nuk shoh pse duhet të shpenzojmë...

Z. Bejtja: Pse mos të jetë kjo e drejtë edhe e EITI-t, këtë detyrim ta kenë edhe ndaj EITI-t?

Z. Aliaj: Nuk jam kundra por deri më sot zotërinjtë që merren me këtë fushë nuk kanë nxjerrë asnjëherë asnjë shqetësim.

Znj. Çinari: Ju jeni dëshmitar...

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Z. Bejtja: E ke gabim këtë. Ne e kemi ngritur si problem.

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Z. Neza: ...edhe te raporti ishte shkruar që kemi pasur vështirësi në mbledhjen e të dhënave, a është kështu që Tatimet nuk i dhanë të dhëna Deloitte dhe ne u mbledhëm që të shohim..?

Z. Aliaj: Jo jo, nuk ishte ky problemi i Deloitte, se ja kanë dhënë të gjitha, e keni gabim se ka ndërhyr zotëria atje...

Z. Neza: A është kështu që Tatimet nuk i dhanë të dhëna Deloitte?

Z. Aliaj: Sami nuk flitet për Tatimet këtu, ata kanë një database shumë të rregullt.

Z. Neza: Flitet për të gjitha çështjet.

Z. Bejtja: Flitet për të gjitha çështjet.

Znj. Hajnaj: Më falni një sekondë. Nëse e mbani mend duhet të jetë edhe të Minutes of Meeting, ju kam thënë shprehimisht që çdo tre muaj kompanitë e kanë të detyrueshme ti dërgojnë të dhënat AKBN-së, por AKBN nuk e ka detyrimin që të na raportoj ne.

Z. Bejtja: Fiks.

Znj. Hajnaj: Dhe kam kërkuar që AKBN-ja të mund t'ja çoj Sekretariatit këto të dhëna, gjë që do jetë shumë më e lehtë për Administratorin.

Z. Aliaj: Po kjo bëhet me një rregullore të thjeshtë, ske nevojë, me një urdhër Ministri bëhet kjo punë.

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Z. Bejtja: Të flasim me rradhë!

Z. Arapi: Më fal ne kemi një Urdhër Ministri që në vitin 2014, për të cilin është në dijeni Dorina, ku zoti Gjikhuri shprehet qartazi që çdo kërkesë e EITI-t është e padiskutueshme nga të gjitha institucionet e varësisë të Ministrisë dhe EITI.

Znj. Çinari:Z oti Gjikhuri nuk urdhëron dot Tatimet, Doganat, etj...

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Z. Hasanlami: Kuadri ligjor që rregullon të gjitha marrëdhëniet pa përjashtim nga fillimi deri në fund, po themi që nga ligji, urdhërat, vendimet gjithë seti i kuadrit ligjor automatikisht rregullon dhe detyron të gjitha subjektet minerare...

Z. Bejtja: ...për raportim.

Z. Hasanlami: ...për të raportuar në AKBN dhe në Ministri edhe rrjedhimisht edhe tek EITI. Dhënia ose marrja e një konsulenti të huaj ose të vëndit nuk ka rëndësi fare në këtë gjë, mua më duket që nuk ka asnjëlloj problem.

Znj. Çinari: Po keqkuptohemi.

Z. Bejtja: Spo merremi vesh.

Z.Hasanlami: E para ky është seti i plotë, të gjitha materialet çfarë duhet me të gjitha subjektet, ja ku i kemi edhe Nafta edhe AKBN-ja edhe ne, pra i kemi të gjitha këto. Sepse unë shoh këtu tek këto termat meqë e mora fjalën duke filluar edhe në fillim, fillon një shqyrtim diagnostifikues kështu thotë për procesin.

Znj. Çinari: Të bëj një sqarim të vogël, ka kërkesa në standartin EITI që ne i kemi të detyruara ti zbatojmë.

Z. Hasanlami: Më fal a ka mundësi?

Znj. Çinari: Më fal ta mbaroj, e kemi detyrim.

Z. Hasanlami: E ke detyrim absolutisht, thuaj standarti është 1,2,3,4,5

Znj. Çinari: Nuk kam mundësi ta implementojmë se nuk kemi mundësi ligjore.

Z. Hasanlami: Kush tha, pse?

Znj. Çinari: Kem pengesë, po nuk mi japin të dhënat

Z. Hasanlami: Ka absolutisht mundësi

Znj. Çinari: Por nuk na i japin...

Z. Hasanlami: Ku ka mungesa këtu? Ti e zëmë e ke me ligj dhe me vendim nëse e ke një subjekt minerar, ne e kemi me ligj dhe vendim të raportohen të ardhurat, të raportohen gjithë treguesit dhe një pjesë e të ardhurave këtu të shkoj për pushtetin lokal, e përcaktuar me vendim qeverie dhe tani çduhet këtu?

Z. Bejtja: Mehmet të lutem! Jo, duhet të jetë se kemi vuajtur njëherë, të kam thërritur 30 herë në zyrë që të më sjellësh informacionin.

Z. Hasanlami: Jo se nuk është ashtu...

Znj. Çinari: Është ashtu.

Z. Hasanlami: Por do ma rregulloj konsulenti mua këtë?

Znj. Çinari: Ç'konsulent, nuk ka konsulent, do bëjmë rishikime do miratojmë Vendime.

Z. Bejtja: Nuk ka konsulent.

Znj. Puka: Do miratosh pastaj gjithë paketën ligjore.

Znj. Çinari: Do bëhet një rishikim ligjor që ta thjeshtosh procesin.

Z. Hasanlami: Në fund thua që ky personi që do përcaktoj këto, në mënyrë që konsulenti të jetë jurist i kualifikuar.

Z. Bejtja: ...*(nuk kuptohet)*

Z. Hasanlami: Unë kam hall çfarë do më ndihmoj mua ose ju?

Znj. Çinari: Do ndihmoj procesin EITI që të rrjedhi natyrshëm dhe mos vijmë më datën 30 dhjetor dhe të jemi duke e vuajtur për të finalizuar një raport.

Znj. Hajnaj: AKBN-ja çdo tre muaj tua çoj detyrimisht këtyre gjithë informacionin.

Z. Aliaj: E ka pra Anila, e dëgjon çfarë thotë. Kush tha që nuk i çon, ti po bën 0 punën e AKBN-së?

Z. Hasanlami: Po, le ta çoj AKBN-ja raportin, dakort.

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Z. Bejtja: Ka mundësi, nuk e kuptoj kundërshtimin tuaj? Të miratohet kështu siç është këtu!

Znj. Hajnaj: Ilir, ti ke qënë ai që e ke thënë ska një database për këtë.

Z. Aliaj: Çfarë kam thënë? Jo, ti po bën 0 punën e AKBN-së.

Znj. Hajnaj: A kemi qënë bashkë që kemi thënë pse nuk jepet informacion në raport?

Z. Neza: Ne duhet të bëjmë një pyetje njëherë, ka probleme përgjatë raportimit apo nuk ka problem? Nëse ka problem përgjatë raportimit atëherë si mund ta zgjidhim këtë problem? Sekretariati ka propozuar këtë rrugë.

Z. Aliaj: Shumë më thjesht...

Znj. Puka: Këtë e kemi propozuar vetë ne nëpër mbledhjet tona.

Z. Aliaj: Më falni, mund të zgjidhet shumë më thjesht se sa me këto terma reference.

Z. Bejtja: Mos na i qaj hallin neve! Të miratohet, është detyrim për neve edhe për të tjerët.

Z. Aliaj: Më lë të flas, si do e bëjmë kështu që miratohet?

Z. Bejtja: Për çfarë je kundra kësaj se spo e marr vesh?

Z. Aliaj: Duroni, unë po flas për diçka tjetër për ta bërë edhe më të thjesht procesin unë them që ne si MSG të draftojmë një rregullore ose një urdhër dhe ja çojmë Kryeministrit dhe të jetë Kryeministri që të urdhërojë edhe tatimet edhe të gjitha.

Znj. Hajnaj: Kush jemi ne që t'ja çojmë Kryeministrit direkt?

Z. Bejtja: E para që se kemi ne si target...

Z. Aliaj: Po si nuk e paskemi ne si target?

Z. Bejtja: Kryeministrisë?

Z. Aliaj: A e çojmë nëpërmjet Ministrisë?

Z. Bejtja: Po mirë pra unë këtë po të them që ti me këtë detyron Ministrinë dhe çdo operator tjetër që të jenë transparent ndaj teje në çdo çast që kërkohet.

Z. Aliaj: Ajo çfarë po them unë është që të kursehen ato para se nuk nevojë e bëjmë ne këtu.

Z. Bejtja: Po nuk është vetëm një pikë.

Z. Aliaj: Po jo një pikë. Kur është urdhëri i Kryeministrit nëpërmjet Ministrisë, se ky si do ja çoj, ku do ja çoj Kryeministrit?

Z. Bejtja: Jo ne do na i sjelli...

Z. Aliaj: Po flasim të njëjtën gjë.

Z. Arapi: Keni humbur nocionin komplet...

Z. Bejtja: Po pra.

Z. Arapi: EITI është Transparency International për të verifikuar rakordimin.

Z. Aliaj: Po.

Z. Arapi: Të dhënat që mbledh AKBN-ja, të dhënat që kanë eksportet...

Z. Aliaj: Po.

Z. Arapi: ...të dhënat që vinë nga tatimet me një mostër që merr ti tek EITI, me një mostër që merr ti vetë te biznesi direkt, live, se ai e ka parashikuar që ti si EITI shkon direkt në vëndburim edhe shikon me ekspertë të jashtëm këto të dhëna që ka rakorduar ky, a janë të vërteta apo nuk janë të vërteta dhe sa është marzhi i gabimit? Ndërsa çështja tjetër, ne ja japim me të vërtetë të dhënat EITI-t dhe EITI do ti marri të dhënat. Në përgjithësi të çoj një numër të dhënash, normalisht mua nuk më pëlqen. EITI tek unë duhet të vij zoti X a ka mundësi të më japësh të dhënat për Y. Çfarë ka bërë ky Y dhe dua të dhënat vetëm për puntorët nuk dua as për prodhimin, as për eksportin. Më kupton ku është nocioni? Nëse ne bëjmë një draft, që propozohet dhe miratohet si paketë sesi EITI të ketë mundësi të depërtojë në të gjitha institucionet shqiptare dhe mos ti dalë asnjë pengesë që jo nuk ti jap. Në këtë rast transparenca është edhe më e gjallë, është edhe më e madhe. Nuk mundet dot asnjë zyrtar i rëndomtë, asnjë burokrat që të thotë unë nuk ti jap se ti nuk e ke në ligj.

Znj. Puka: Është direktiva Evropiane për EITI-n që pikërisht ...

Z. Aliaj: Çështja është që pjesën e bizneseve private e mbuloni ju, pra zotëria, zotëria dhe ju...

Z. Bejtja: ...po nuk të bie informacion

Z. Aliaj: E ka me Legjislacion.

Z. Arapi: Ilir, shiko çfarë do të thotë se nuk e kupton mirë, atij nuk i intereson, sa është masa administrative 100 mijë lekë-15 mijë lekë (të reja). Thotë i nderuar zotëri sa e kam marzhin e fitimit unë 1000 tonë = x lekë, pse të deklaroj unë në AKBN, pse të kem gjurmë unë? Nuk po deklaroj fare.

Z. Hasanlami: Azbi e ke gabim!

Z. Arapi: Me këto raste kapen ata.

Z. Aliaj: Ai kalon nëpërmjet doganës se ska ku shkon.

Z. Arapi: Ai e ka detyrim ligjor të thotë mos vrit dhe ti vret.

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Znj. Hajnaj: Ju lutem a t'ju bëj një pyetje? Si kemi qënë me afatet e raportimit? Dua një përgjigje shkurt.

Z. Bejtja: Me vonesë.

Znj. Hajnaj: Pse?

Z. Bejtja: Sepse nuk i raporton njeri.

Znj. Hajnaj: Nëqoftëse këto nuk raportojnë tek AKBN-ja...

Z. Hasanlami: Raportojnë ato se janë të detyruara.

Znj. Hajnaj: Nëse nuk raportojnë duhet ti nxjerrë raportin dhe përgjegjësinë duhet ta mbaj AKBN-ja.

Z. Hasanlami: Absolutisht po.

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Znj. Hajnaj: Dhe këtë neve duhet ta bëjmë me ligj! Duhet ta kenë me detyrim që çdo tre muaj që marrin informacionin duhet t'ja dërgojnë informacionin Sekretariatit. Edhe kjo ka qënë pengesa dhe 100 herë e kemi thënë.

Z. Arapi: Ka të drejtë sepse deri në vitin 2013, po po deri në tetor të vitit 2013 raportimet në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, si vjetore, si mujore, si tre mujore ishin në rangun 25%, maksimumi 34%, ndërsa mbyllja e tremujorit të parë të vitit 2015 ka arritur në rakordim 97%.

Z. Aliaj: Bravo!

Znj. Hajnaj: Kjo më intereson atë 3% pse nuk e ke?

Z. Arapi: Atë 3% nuk e kam sepse është ...

Znj. Hajnaj: Jo mos e kthe ashtu ti, 3% pse nuk e ke duhet të të kërkoj llogari unë ty.

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Z. Bejtja: A mund t'ju bëj një pyetje se ikët nga thelbi? Kam një pyetje jeni dakort me termat e referencës?

Pjesa më e madhe përgjigjen dakort!

Z. Spahiu: Unë jam dakort sepse edhe pse vjet e kemi përfshirë në ligjin për rentën minerare por prapë ka nevojë ose për aktet ligjor ose për rishikim.

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Znj. Hajnaj: Duhet të përcaktohen një nga një të gjitha institucionet përkatëse të jenë të nominuara.

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Z. Aliaj: Unë jam kundra, a ka mundësi të jap një shpjegim të vogël pse jam kundra?

Z. Bejtja: Po.

Z. Aliaj: Jam kundra sepse duke u bazuar në diskutimet që u bënë në këtë moment këtu, në këtë takim, flitet më shumë për pengesa dhe nga ekperienca ne e kemi shtyrë disa herë edhe më përpara 2013-ës por edhe vjet më duket për mungesë të dhënash nga institucinet publike siç janë doganat dhe tatimet. Dhe këto nuk zgjidhen me këtë por zgjidhen me një urdhër Kryeministri.

Z. Bejtja: Ne vetdeklarimi na ka munguar .

Z. Aliaj: Më fal ta mbaroj. Unë e kujtoj shumë mirë vjet dhe ne kemi bërë një debat shumë të fortë, ai zotëria që kam përballë ka thënë që do i lëj edhe një javë afat dhe do i nxij jetën me gjoba dhe do ju heqim.

Z. Hasanlami: I kemi vënë gjoba.

Znj. Hajnaj: Ti Ilir mund kesh të drejtë por edhe Kryeministri do të thotë ku e di ti që nuk përgjigjen ata, ma jep pak me shkrim do të thotë ai, dhe duhet ti vendosin detyrim ligjor gjithë institucioneve që duhet të raportojnë.

Z. Bejtja: Vazhdojmë me pikën tjetër të rregullores unë ju kërkoj ndjesë se jam te Këshilli Mbikëqyrës në OST.

Znj. Çinari: Duhet ta finalizojmë dhe a jemi me shumicë po apo jo?

Z. Neza: Çfarë është kjo tjetra që nuk do jesh?

Z. Bejtja: Termat e Referencës të MSG-së.

Z. Aliaj: Po këtu duhet të ishe...

Z. Bejtja: Nuk ka problem do jem dakort me ju.

Z. Aliaj: Po s'je, se qëparë më the që do e miratojmë.

Z. Bejtja: Jo jo, thamë për konsulencën ligjore.

Z. Aliaj: Vazhdo.

Z. Bejtja: Dëgjo, nëse ndonjëri nga ne këtu do ishte komod të mos ndryshonte asgjë sepse është problem për neve që të mos ndryshoj, këtu jam unë se përfaqësoj Ministrinë edhe sa

kërkesa ka për info të jesh i sigurt ti që janë kokëçarëse. Info KM, info Ministria e Ekonomisë, info Ministria e Financave, info AKBN, info Banka Botërore, Info Tatim-Taksat, info Doganat çdo ditë këtu humb një kohë e madhe me info sepse akoma nuk është standartizuar informacioni të bëhet transparent për të gjithë që çdo kush nuk ka nevojë më të kërkoj diçka por të ketë akses në të dhënat. Nëse ne do arrijmë ndonjëherë të shkojmë në këtë pikë me një çerek hapi ose me një të qindën e hapit me këtë konsulencë dhe akoma më tepër me gjëra të tjera nesër do na heqin ne shumë barrë. Dmth, nuk është se unë jam dakort nëse kërkohet nga dy- tre veta apo jo, them që kam vuajtur nga kjo punë edhe detyrimi do të na ndihmojë.

Z. Arapi: Që të informoj dhe MSG-në, AKBN-ja brënda tre muajve, maksimumi pesë bën online për institucionet të cilat do kenë akses në sistemin elektronik për të dhënat e çdo poseduesi, lejet minerare.

Z. Bejtja: Shumë shpejt do bëhet edhe SHGJSH.

Znj. Hajnaj: Dhe ne do arrijmë pastaj si e ka Norvegjia, ata thonë ne nuk e kemi nevojë ta bëjmë çdo vit raportin se janë shpenzime të mëdha. Informacionet e detajuar janë atje dhe ka mundësi ta bëjmë njëherë në tre vjet, thonë ata.

Z. Bejtja: Po ndoshta edhe ashtu mund të bëhet por ne jemi larg kësaj gjëje.

Znj. Hajnaj: Nëse do bëhet kjo transparencë...

Z. Aliaj: Po do bëhet thotë, maksimumi pesë muaj. Kështu thotë ky pse mos ta besoj?

Znj. Hajnaj: Shumë mire për ne.

Z. Bejtja: Do jem dakort me gjithë vendimin tuaj!

Z. Aliaj: Edhe me ne të pakicës që kundërshtojmë?

Z. Arapi: Po nuk pati zëra të ndryshëm nuk do ketë kuptim mbledhja.

Z. Bejtja: Tema ime e masterit ka qenë...

Z. Arapi: Për pakicat.

Z. Bejtja: The rights of minorities dhe thotë kanë të drejtën e vetos sa herë ju kërcënohet ekzistenca. Kështuqë unë jam gjithmonë pro pakicave.

Z. Aliaj: Nuk besoj se më kërcënon dikush ekzistencën...

Z. Bejtja: Nuk ka lidhje ti tani. Përkthimi nga shqipja në shqip është gjë e madhe.

Z. Aliaj: Kjo është kryesorja.

Z. Bejtja: Por megjithatë unë po të them edhe njëherë është termi i përkthyer në këtë formë. Të jeni të sigurt që unë jam gjithmonë pro minoritetit!

Z. Aliaj: Shumë mirë.

Z. Bejtja: Unë jam pro shoqërisë civile dhe kjo është kryesorja.

Z. Aliaj: E di.

Znj. Çinari: Vazhdojmë! Termat e Referencës për MSG-në. Ne do të fillojmë Validimin në Tetor 2016, është ai procesi që certifikon procesin EITI. Si pjesë e procesit të Validimit një dokument shumë i rëndësishëm është aprovimi i Termave të Referencës për veprimtarinë e MSG-së, bërja e këtyre dokumentave zyrtare dhe përgatitja natyrisht në përputhje me Standartin EITI. Këto Terma Reference i kemi draftuar ne në Sekretariat. Kemi marrë për bazë standartin EITI dhe tre dokumente që mbahen si më të mirat aty, në familjen EITI le të themi, janë Filipinet, Britania e Madhe edhe Nigeria. Këto janë dhe dokumentat më të mira përse i përket MSG-së. Ky është një dokument i hapur për të gjithë, është një draft, është një projekt, aty mund të gjeni dhe gjëra që nuk ju pëlqejnë dhe hajde ti diskutojmë dhe përmirësojmë por duhet të jetë gjithmonë në përputhje me atë që kërkohet në standart.

Z. Aliaj: Shyqyr që s'qënka dhe Mali se do kishte problem Mehmeti.

Znj. Çinari: Jo, jo. Nigeria ka Termat më të mira të Referencës.

Znj. Hajnaj: Po atë e keni parë MSI.

Znj. Çinari: Natyrisht, ata rekomandojnë Anila.

Znj. Hajnaj: Ata rekomandojnë por gjithë rekomandimet duhen marrë parasysh. Po të bazohesh në...ata i kanë parë të gjitha llojet e dokumentacioneve .

Znj. Çinari: Janë rekomandime.

Znj. Hajnaj: Jo.

Znj. Çinari: Cilat janë dokumentet më mira, cili është standarti?

Znj. Hajnaj: Unë skam pasur mundësi ta shoh se kam pasur problem me emailin kështu që nuk mund të flas konkretisht.

Znj. Çinari: Gjërat që janë në interes për ju i flasim, i diskutojmë, ndoshta sdo ta mbarojmë gjithë diskutimin sot se kam përshtypje që është me interes por mund të fillojmë.

Z. Spahiu: Mund të bëni një përmbledhje shumë të shkurtër.

Znj. Çinari: Termat e referencës së MSG-së tregojnë se si rregullohet kjo veprimtari. Atëhere, siç e dini dhe ju të gjithë EITI ka dy principe, zbardhjen e informacionit, të dhënave, publikimi i tyre etj. dhe veprimtaria rregullohet nëpërmjet një grupi interesi institucional pune ku përfaqësohen tre parti, shoqëria civile, kompanitë operatore në treg edhe qeveritë respektive. Marrdhënia e MSG-së duhet dokumentuar, duhet përcaktuar qartë se kush është roli i secilit grup, kush janë të drejtat, detyrimet, mënyra se si duhet të operojmë. Ne kemi një dokument të vjetër, është minimal dhe nuk mund të vlej për një procesi validitimi, nuk i përgjigjet standartit, nuk parashikon asgjë që ka standarti. Quhet rregullore ku thotë MSG është kjo, ka këta antarë, mbledhjet bëhen në këtë formë, protokollit mbahet në këtë formë, me pak fjalë jo një dokument i mirëfilltë. Kështu që kjo quhet le të themi një dokument i ri.

Z. Spahiu: Që duhet ta miratojmë ne si MSG?

Znj. Çinari: Duhet ta miratojmë ne si MSG. Ky dokument duhet të miratohet nga Oslo, nga partnerët që financojnë EITI-n dhe do ta nënshkruaj Ministri.

Z. Spahiu: Ok! Se ta miratojmë ne për veten tonë më duket pak kështu sikur...

Znj. Çinari: Ky është detyrim që ne ta miratojmë dhe ta pranojmë si dokument.

Z. Spahiu: Se vë në dyshim, por duhet një autoritet më i lartë që ta miratojë.

Znj. Çinari: Ky grup këtu e pranon këtë dokument dhe pranon të veproj sipas këtyre principeve. Më pas ky dokument merr aprovimin e partnerëve, të EITI Ndërkombëtar, të Bankës Botërore, të financuesve të tjerë sepse një financues nuk mundet të financoj veprimtarinëqë keni të shkruar këtu.

Z. Spahiu ...*(nuk dëgjohet)*

Znj. Çinari: Për sa i përket përfaqësuesve të qeverisë po. Ka një propozim për sa i përket numrit të antarëve, ky është thjesht një propozim dhe jemi të lire të diskutojmë, mund të biem dakort, s'mund të biem dakort. Nëse futja e Hidroenergjisë në raportet EITI, kërkon angazhimin e gjithë institucioneve që merren me energjinë elektrike, KESH, ERE dhe kjo do të bëj që të ketë përfaqësues nga këto Agjenci shtetërore në MSG, pra e prish peshën aktuale. Për këtë arsye ne kemi vendosur shtatë përfaqësues për secilin grupim por kjo është përsëri draft, është propozim.

Z. Aliaj: Më fal a mundem të them unë diçka?

Znj. Çinari: Po, natyrisht!

Z. Aliaj: E para, unë kam dërguar komentet e mia që i keni bashkalidhur.

Znj. Çinari: Po i kemi parë. Janë komente tuaja personale, të grupimit që përfaqësoni apo të grupimit të shoqërisë civile?

Z. Aliaj: Këto komente janë të zotit Ilir Aliaj.

Znj. Çinari: Janë tuajat personale pra. Ok, se kjo është e rëndësishme.

Z. Aliaj: Kur thuhet zoti Ilir Aliaj ska diskutim se kush është mbas Ilir Alisë.

Znj. Çinari: Jo, pyetja është i keni komentuar me qytetarët që përfaqësoni, me grupimin këtu?

Z. Aliaj: Sigurisht që po.

Znj. Çinari: Me qytetarët që përfaqësoni, ok.

Z. Aliaj: E para kjo, e dyta proçesi është jo transparent. Vjet kemi nisur një proçes ku ka qënë i ftuar edhe profesor Përparimi.

Znj. Çinari: Po.

Z. Aliaj: Dhe kemi lënë takimin e dytë, kemi bërë dy takime tek zyrat tuaja.

Znj. Çinari: Dhe ky proces përfundoi pa asnjë dokument.

Z. Aliaj: Sepse nuk u vazhdua. Janë proçesverbalet aty që ne e kemi lënë të takohemi përsëri dhe nëse nuk është ngritur një grup pune për të sjellë këto terma reference, kush i ka bërë këto?

Znj. Çinari: I kemi draftuar ne në Sekretariat.

Z. Aliaj: Ju?

Znj. Çinari: Po.

Z. Aliaj: Me çfarë standartesh?

Znj. Çinari: Referuar standartit EITI.

Z. Aliaj: Ku e ke standartin, ma thuaj pak standartin EITI tek të gjitha këto komentet, tek të gjitha ato që ke shkruar ti?

Znj. Çinari: Përgjatë gjithë rrugës do i shohim.

Z. Aliaj: Tek ndërhyrja në çështjet e shoqërisë civile?

Znj. Çinari: Ku është ndërhyrja në çështjet e shoqërisë civile?

Z. Aliaj: Ja, të kam bërë komentet. Ta lexoj gjithë komentin?

Znj. Çinari: Ku është në dokument?

Z. Aliaj: Ja se po ta lexoj të gjithën që të jenë edhe të tjerët në dijeni se ndoshta dhe se kanë lexuar.

Znj. Çinari: Ne kemi draftuar shumë dokumenta të tjera që kanë qënë me grup pune dhe i kemi sjellë për ju, i kemi komentuar, i kemi aprovuar, s'i kemi aprovuar. Ne draftojmë të gjitha dokumentat që vinë këtu.

Z. Aliaj: Ne jemi antarë të MSG-së.

Znj. Çinari: Ju ishit pjesë e një grupi pune dhe nuk keni finalizuar asnjë dokument!

Z. Aliaj: Sepse nuk u mbledhëm përsëri.

Znj. Çinari: Mbledhuni ju Ilir, ju jeni grupi.

Z. Aliaj: Jo, ju jeni për të rregulluar çështjet e brendëshme të MSG-së.

Znj. Çinari: U krijua një grup pune.

Z. Aliaj: Jo, jo e ke gabim, AlBEITI çfarë është?

Znj. Çinari: AlBEITI është një Agjenci Shtetërore që ka një mandat të vetin.

Z. Aliaj: Çfarë do të thotë mandat se unë e di që është agjenci shtetërore dhe që ka mandate të vetin.

Znj. Çinari: Është një institucion shtetëror, ekzekutiv i vendimeve të MSG-së.

Z. Aliaj: Nuk bën asnjë menaxhim, asnjë gjë?

Znj. Çinari: Jo.

Z. Aliaj: Pse na mbledhët këtu sot? Kush na mbledhi, kush e çoi ftesën?

Znj. Çinari: Unë ju mbledh por mund të na ftoni ju Ilir, mund të na ftoj Samiu.

Z. Aliaj: Proçesin e nisët ju.

Znj. Çinari: Po sepse gjej interes për ta çuar përpara.

Z. Aliaj: Proçesin vjet e keni nisur ju.

Znj. Çinari: Sepse gjejmë interes për ta çuar përpara.

Z. Aliaj: Po pse se vazhduat prapë?

Znj. Çinari: Sepse nuk pati sukses.

Z. Aliaj: Kush tha që nuk pati sukses? Ne punuam shumë mirë me profesorin.

Znj. Çinari: Tek dokumenti aktual kush janë problemet që keni?

Z. Aliaj: I kam ngritur të gjitha, ti lexoj sepse një pjesë ndoshta dhe nuk e kanë lexuar.

Znj. Çinari: A doni të marrim më shumë kohë për këto Termat e Reference dhe mos të hymë në diskutime pa kualitet?

Z. Arapi: Kur hymë në një diskutim ti japim zgjidhje si do ta lëmë, jo vetëm me kundërshtime.

Z. Aliaj: Jo nuk është kundërshtim, unë i kam çuar me letër nuk është kundërshtim.

Znj. Çinari: Çfarë nuk i pëlqen hajde ta diskutojmë, është draft, është një propozim.

Z. Aliaj: Ajo çfarë unë propozoj në shtesë të kësaj që edhe ju propozoni është që të ngrihet një grup pune përsëri dhe secili nga ne...

Znj. Çinari: Grupi i punës të ngrihet, ka vetëm një muaj kohë.

Z. Aliaj: Po një muaj.

Znj. Çinari: Do punoni në mënyrë të pavaruar. Ne nuk duam të marrim pjesë si Sekretariat.

Z. Aliaj: Pse?

Znj. Çinari: Nuk e gjej me vënd!

Znj. Puka: Sepse Sekretariti ka punuar njëherë vetë.

Znj. Çinari: Se kemi punuar më shumë se sa njëherë dhe nuk ka rezultuar kështu që në të drejtën tuaj grupin mund ta krijoni dhe të finalizoni dokumentin.

Z. Aliaj: Të kishit krijuar grupin e punës, ti kishit bërë kërkesë secilit grup pjesëmarrës në MSG, edhe siç u bë në fillim që ishte krejt normal dhe transparent dhe jo si kësaj radhe.

Znj. Çinari: Ilir është një draft, është një propozim. Termat e Referencës për raportin EITI, pse nuk i komentuat si jo transparente. Termat e referencës për raportet e tjera EITI, pse si keni konsideruar si jo transparente që është edhe veprimtaria më madhore e kësaj MSG-je?

Z. Aliaj: Kush tha, ne i kemi komentuar gjithmonë.

Znj. Çinari: Si Jo transparente, pse si keni komentuar ndonjëherë si jo transparente? Të gjitha këto dokumentet i kemi përgatitur ne.

Z. Aliaj: Cilat terma?

Znj. Çinari: Çdo term reference që ju ka ardhur në tavolinë.

Z. Aliaj: Sa herë që kemi pasur probleme edhe për terma reference e Administratorit?

Znj. Çinari: Pse si keni komentuar si jo transparente? Sepse kemi qënë ne që i kemi sjellë në tavolinë për ju.

Z. Aliaj: Po, pse duhet gjithmonë që jeni ju keq? Kur e bën mirë punën pse duhet të them je keq?

Znj. Çinari: Po pse kësaj here është jo transparente, se normale nga zyra ime do i shkruaj nuk mund ti shkruaj këtu?

Z. Aliaj: Po pse mendon se sa herë do bëni ju një veprim, duhet të jetë keq, jo nuk është kështu!

Znj. Çinari: Flasim konkretisht, fillojmë nga paragrafi parë? Nëse nuk keni kohë, lëmë një mbledhje tjetër të MSG dhe të jemi të përgatitur të gjithë.

Z. Aliaj: Më fal, unë bëra një propozim në vazhdim të asaj që propozuat ju...

Znj. Çinari: Po?

Z. Aliaj: Ju thatë që mund të bëhet një shtyrje, apo jo?

Znj. Çinari: Një muaj kohë, na e sillni dokumentin të finalizuar, ne nuk jemi pjesë e këtij procesi për transparencë të plotë.

Z. Neza: E ke fjalën për dokumentin e finalizuar të të gjithë ToR apo vetëm për çfarë i përket shoqërisë civile?

Znj. Çinari: Për të gjithë.

Z. Aliaj: Për të gjithë.

Znj. Çinari: Nëse do ngrihet grup pune, për të gjitha. Nëse Ju nuk bini dakort me këtë dokument bëni një dokument të ri. MSG-ja i ndërton Termat e Referencës.

Z. Arapi: Unë jam i mendimit të vazhdojmë dhe aty ku ngelet për të diskutuar grupi punës, ja lëmë grupit të punës. Unë them ti kalojmë një nga një.

Z. Aliaj: Më fal po ka disa antarë të MSG që po e shohin për here të parë këtë material.

Znj. Puka: Ku e di ti që po e shikojm për herë të parë ne, se e ke thënë nja tre here?

Z. Aliaj: Kush të tha ty, ja ku e ke kolegen.

Znj. Hajnaj: Unë po e shoh për herë të parë, por nuk ka shumë rëndësi kjo.

Znj. Puka: Po ja vetëm një nuk i ka parë, jo disa. Më mirë ti kalojmë një nga një, për sa kohë ka një afat urgjent se dhe ne nuk kemi kohë të vimë gjithmonë. Ti kalojmë një nga një se është shumë i thjesht si dokument. Më shumë janë komentet tuaja, se sa kjo.

Z. Aliaj: Është i thjesht për ty...

Znj. Puka: Po.

Z. Aliaj: Po shumë mirë, rri aty, mbaj votën tënde!

Znj. Çinari: Kjo ka nisur vjet në korrik.

Znj. Hajnaj: Mua nuk më kanë ardhur se më kanë shkruajtur gabim emailin.

Znj. Puka: Po të paktën të jemi produktiv se unë kam ardhur nga Vlora.

Z. Aliaj: Po shumë mire keni bërë që keni ardhur.

Znj. Çinari: Ju lutem, ti lëmë batutat pa vlerë, kemi të gjithë shumë punë. Të ecim sipas dokumentit dhe nëse kemi kohë i shohim tani, nëse nuk kemi kohë e shtyjme për një ditë tjetër.

Z. Aliaj: Po prisni se u bë një propozim, nga ju dhe nga unë.

Znj. Çinari: Cili është, a e miratuam propozimin tuaj?

Z. Aliaj: Po kjo pra është se nuk u hodh në votë.

Znj. Çinari: Ta hedhim në votë.

Z. Spahiu: E hedhim në votë.

Z. Aliaj: Më falni, që ta përmbledh edhe njëherë me dy fjalë. Nga Sekretariati, vjen propozimi për mundësi shtyrjeje diskutimi dhe mund ta bëjmë diskutimin edhe online. Dhe unë them propozim shtesë, duke u bazuar edhe në propozimin e Sekretariatit, them që një shtyrje të ngrihet edhe një grup pune që ska nevojë të takohet fizikisht por edhe online punohet. Ne të gjithë emailt e kemi dhe mund të punohet edhe kështu. Dhe mbas 20 ditësh, pa shkuar një muaj, ne ta përfundojmë draftin dhe të jetë drafti vetëm për aprovim, kaq.

Znj. Çinari: Po pse ky s'është për aprovim?

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Z. Hasanlami: Unë kam një mendim, i gjithë materiali çfarë është shkruar dhe ne jemi dakort absolutisht ti kalojmë dhe aty ku ngecim, në disa pika ku mund të jenë me të drejtë, i shohim tani dhe po gjykojmë që është e drejtë për ti ndryshuar i ndryshojmë ose ti lëmë për ridiskutim.

Z. Spahiu: Unë s'jam dakort ta shtyjme por jam dakort ti shohim tani.

Z. Hasanlami: Po sot, kështu thashë dhe unë.

Znj. Puka: Edhe unë them ti shohim sot.

Z. Aliaj: Duke vazhduar këtë ide, nëse ne nuk biem dakort për një pikë. Në gjithë këtë material nuk bimë dakort për një pikë

Z. Hasanlami: Dakort, do ta diskutojmë?

Z. Aliaj: Kur do ta diskutojmë?

Z. Hasanlami: Pas një jave.

Z. Arapi: I diskutojmë tani

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Z. Neza: Një sekondë, ne e kemi një material, unë dhe ti, ja kemi bërë komentet këtij materiali dhe tani nuk kemi pse ta nisim edhe njëherë nga e para. Ne kalojmë pikat të cilat nuk ka kontensime dhe në pikat që ka kontenstime dhe nuk biem dakort i diskutojmë.

Z. Arapi: Nëse Anila pranon ti diskutojmë sot, le ti diskutojmë.

Znj. Hajnaj: Patjetër, pse mos ti diskutojmë?

Z. Arapi: Ilir ti i ke bërë komentet e tua, Samiu i ka bërë komentet e veta, ne po i bëjmë komentet dhe zonja që si ka parë bie dakort ti diskutojmë.

Znj. Hajnaj: Ja kërkova Milit të mi nisi. Iliri, po pati te pjesa jonë diçka, mund të diskutojmë.

Znj. Çinari: Jeni të lirë ta draftoni si të doni Anila, por nga ju nuk ka ardhur asnjë propozim deri më sot. Proçesi ka filluar në korrik 2015 dhe proçesi udhëhiqet nga MSG-ja dhe jo nga Sekretariati. MSG-ja drafton, MSG-ja propozon, dhe tani e marrim ne iniciativën sepse kemi interes që proçesi të eci përpara.

Znj. Puka: Po shumë mirë, hajde ecim, të fillojmë.

Znj. Çinari: Fillojmë hyrje. Keni komente për hyrjen? Objektivi dhe Misioni i EITI-t në Shqipëri. Qëllimin e këtyre Termave Referencës. Baza ligjore, ku Anila shkruhet që këto terma reference hartohen edhe në bazë të raportit MSI integrity.

Z. Hasanlami: Te cila pikë je?

Znj. Çinari: Te baza ligjore.

Z. Hasanlami:Po te hyrja?

Znj. Puka: Mbaroi Hyrja skemi komente tek Hyrja.

Znj. Çinari: Po ecim bllok pas blloku.

Z. Aliaj: Janë disa komente që duhen përmirësuar edhe në aspektin viziv.

Z. Hasanlami: Kjo është e drejtë

Znj. Çinari: Ku të fillojmë, të ecim me rradhë. Baza ligjore

Z. Aliaj: Tek hyrja.

Z. Hasanlami: Fillojmë tek hyrja që ta marrim më seriozisht. Ka një draft propozim të paraqitur nga EITI, ka dhe disa vërejtje të bëra nga Iliri dhe autor të tjerë.

Z. Aliaj: Nga Samiu, apo për këtë pikë jo?

Z. Neza: Nuk kam bërë koment për këtë pikë.

Z. Hasanlami: Nga Samiu, ok. Tani i shohim dhe nëse keni të drejtë të ndonjëra nga pikat edhe mund ta ndryshojmë, pse jo? Ju thoni nuk është e nevojshme por për mua këto janë gjëra që mund të rregullohen, janë gjëra të vogla.

Z. Arapi: Keni ndonjë kundërshtim me propozimin që ka bërë Iliri tek Hyrja?

Z. Hasanlami: Nuk ka ndonjë kundërshtim

Znj. Hajnaj: Të përmendet që me ndryshimet e standartit EITI, ka dalë e nevojshme rishikimi i Rregullores së mëparshme, këtu nuk po lexoj që ka pasur Rregullore

Z. Hasanlami: Shumë mirë, mund të plotësohet

Znj. Çinari: Ne e kemi pasur një rregullore

Znj. Hajnaj: Prandaj duhet përmendur që me ndryshimet e standartit të ri EITI, del e nevojshme përmirësimi i Rregullores së Brëndëshme me këto pika.

Z. Aliaj: Kemi referencë ligjore, udhëzimin e Këshillit të Ministrave.

Znj. Çinari: Standarti nuk ka ndryshuar referuar MSG-së.

Znj. Hajnaj: Jo jo, sepse ajo Rregullore është krijuar me standartin e vjetër të EITI-t.

Znj. Çinari: Po po patjetër.

Znj. Hajnaj: Mund të perifrazohet në këtë mënyrë.

Znj. Çinari: Po.

Z. Hasanlami: Unë mendoj që edhe vendosja e objektivit dhe misionit, as nuk prish punë as nuk rregullon punë është thjesht për tu vendosur.

Z. Aliaj: Unë për atë thashë që janë disa gjëra, udhëzimi i Këshillit të Ministrave si referencë ligjore.

Znj. Çinari: Ky është dokument publik, më falni nuk është vetëm për ne, është edhe për ata që e lexojnë.

Znj. Hajnaj: Po po.

Znj. Çinari: Misioni dhe Objektivi duhet të jenë të qarta, ky nuk është dokument vetë për ne që e dimë, është dokument publik.

Z. Aliaj: Ne po flasim për pikën e parë, Hyrjen.

Znj. Çinari: E kaluam pra, jemi te Misioni dhe Objektivi.

Znj. Hajnaj: Aty të shtohet që bazuar në standartet e reja EITI, Rregullorja e parë është e vjetër dhe ka nevojë për përmirësime.

Z. Arapi: Ok në rregull.

Znj. Çinari: Pika dy

Z. Hasanlami: Treshi

Z. Aliaj: Pika tre

Znj. Çinari: Qëllimi

Z. Hasanlami: Qëllimi

Z. Aliaj: I Rregullores sepse kjo që po bëjmë ne është Rregullore, apo jo?

Znj. Çinari: Po, por kjo në gjuhën e familjes EITI quhet Terma Reference. Nëse duam t'ja vendosim emrin Rregullore ja vendosim.

Z. Aliaj: Jo jo më falni, këtu ngulmoj dhe e dini pse ngulmojë këtu sepse kjo është thjesht gjuhë teknike legjislativë që përdoret në çdo dokument të shtetit Shqiptar por edhe jashtë Shqipërisë.

Znj. Çinari: Kush?

Z. Aliaj: Kjo pra që quaj unë Terma Reference. Nuk duhet quajtur Terma Reference por qëllimi, objektivat e Rregullores them unë.

Znj. Hajnaj: A mund ta themi rregullorja e MSG-së?

Z. Aliaj: Po jo Anila...

Znj. Hajnaj: Si propozon ti?

Znj. Çinari: Ky është editim tani që po bëjmë ne.

Z. Aliaj: Po mirë nuk ka ndonjë problem, çfarë problemi ka?

Znj. Çinari: Se s'kemi edituar termat e referencës të Administratorit të Pavarur...

Znj. Puka: Ku është kjo se nuk po e kuptoj çfarë problemi ka:

Z. Hasanlami: Pika tre.

Z. Aliaj: Ta bëjmë hap kllapë "Rregullore", mbyll kllapë.

Znj. Çinari: E zëvendësojmë, e bëjmë Rregullore, e heqim Terma Reference.

Z. Hasanlami: Ë zëvendësojmë dhe e mbyllim.

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Z. Aliaj: Është problem nga pikëpamja teknike dhe legjislativë. Për mua e lejmë si të doni.

Znj. Çinari: Rregullore.

Z. Hasanlami: E shkruajtem Rregullore, vazhdojme tek pika 4. Roli, Pergjegjesite dhe te drejtat e MSG-se.

Znj. Puka: Eshte pika 4 e Ilirit, jo pika e materialit.

Z. Aliaj: I kam marrë me rradhë të gjitha pikat.

Z. Arapi: I ka marrë me rradhë dhe ka thënë këtu nuk ka komente dhe kur nuk ka, s'ka!

Znj. Hajnaj: I ka shkruajtur me pika.

Z. Hasanlami: Po pika 4.

Znj. Çinari: Eshtë pikë për pikë Standarti EITI.

Z. Aliaj: Shumë mirë. A ka mundësi që ta bëjmë pak, duke qënë se ky dokument është publik jo vetëm për ne por një qytetarët në një fshat nëse i bie në dorë kjo nuk e kupton çfarë është kjo punë.

Znj. Çinari: Standarti EITI e ka bërë të paqartë?

Z. Arapi: Jo,jo.

Znj. Çinari: Kjo është pjesë e standartit EITI.

Z. Arapi: Iliri thotë kështu një qytetar me tetë-vjeçare ose me shkollë të mesme, pak rëndësi ka, nuk e di se kush është EITI dhe nuk arrin ta interpretoj dot fjalën EITI.

Z. Aliaj: A ka mundësi pak më gjërë dmth, kjo është ideja?

Znj. Çinari: Ky është formulimi sipas standartit, do deformatojmë standartin? Eshtë formulimi sipas standarti pikë për pikë!

Znj. Hajnaj: Përkthejmë pak në shqip si është MSI, grupi ndërinstitucional i punës.

Znj. Çinari: Jo nuk është grupi ndërinstitucional i punës është grupi shumë aktorësh.

Znj. Puka: Eshtë grupi shumë aktorësh.

Z. Arapi: Të rrij ashtu siç është!

Z. Aliaj: Këto janë sygjerime...

Z. Arapi: Kalojmë tek pika tjetër!

Znj. Çinari: Pika pesë.

Z. Aliaj: U kalua, u miratua ashtu siç është. Ashtu e doni, ashtu lëjeni!

Z. Hasanlami: Pesa!

Znj. Çinari: Çfarë ke parasysh Ilir, çfarë lloj vendimesh mund të marr MSG-ja?

Z. Aliaj: Po ta kemi të qartë çfarë vendimesh kemi të drejtë të marrim ne. Ta kam dhënë shëmbullin këtu poshtë.

Znj. Çinari: Ne e kemi një objektiv dhe një mision. Bazuar mbi objektivat dhe misionin dhe çdo gjë që diskutohet është në tagrin tonë të marrim ose jo vendime.

Z. Aliaj: Unë këtu them për ti bërë sa më të thjeshta dhe sa më të qarta për të gjithë.

Znj. Çinari: Ju lutem propozoni konkretisht!

Z. Aliaj: Edhe këtu kam marrë një shëmbull.

Znj. Çinari: Po?

Z. Aliaj: Flitet për rentën minerare dhe asnjëherë nuk është diskutuar në këtë tavolinë për uljen apo ngritjen e saj.

Znj. Çinari: E keni ngritur si çështje?

Z. Aliaj: Si jo, disa herë?

Znj. Çinari: Dhe?

Z. Aliaj: Dhe nuk kemi marrë përgjigje

Znj. Çinari: Nga kush?

Znj. Puka: Po ne nuk marrim dot vendime për këto gjëra.

Znj. Çinari: Nga kush nuk keni marrë përgjigje?

Z. Aliaj: Ne edhe bashkë kemi kërkuar informacion për çështjen e rentës minerare dhe ske arritur të marrësh informacion as nga Ministria e Financave.

Znj. Çinari: Po, nuk kemi arritur se këto gjëra nuk bëhen kështu.

Z. Aliaj: Po si bëhen?

Znj. Çinari: Po kjo do të thotë që kjo MSG duhet të jetë shumë aktive dhe duhet të përdori të gjitha llojet e formave që njeh, si grupe interesi për ta çuar çështjen përpara. Apo jo?

Z. Neza: Dorina, kjo që ka shprehur Iliri këtu nuk është as objektiv, as mision. Është aktivitet dhe ne si aktivitet nuk mund ta fusim por ne mund të shtojmë një fjali ku, MSG-ja të përfshihet në debatet dhe diskutimet e rregullimeve ligjore që lidhen me transparencën e burimeve natyrore.

Z. Hasanlami: Absolutisht po!

Znj. Çinari: Shumë me vënd, shumë dakort!

Z. Hasanlami: Shtojeni.

Znj. Çinari: Ta formulojmë edhe njëherë fjalinë.

Znj. Hajnaj: Te konsultimet, se dalim tek ajo pjesa e rentës që ne papritur doli që kishte shkuar te 5%.

Znj. Çinari: Mund ta ngrejmë tani Anila.

Znj. Hajnaj: Jam shumë dakort dhe këtë po thotë edhe Samiu që të jemi pjesë e debatit.

Z. Hasanlami: Ne në fakt kësaj rradhe e kemi kaluar rentën pa ju pyetur, e kemi ulur atë.

Z. Arapi: Ndoshta dhe mund të keni të drejtë por ka qënë një këmbëngulje jashtëzakonshme e Ministrisë së Energjisë për uljen e rentës minerare.

Z. Aliaj: Azbi dakort nuk jemi kundra.

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Z. Neza: Kalojmë tek pika 6.

Z. Hasanlami: Po, pika 6

Z. Aliaj: Kush na e përcakton çfarë është interesi kombëtar? Se për mua interesi kombëtar është që të luftosh korrupsionin, të jesh transparent etj etj, por duhen përcaktuar këto sepse interesi kombëtar është shumë subjektiv. Edhe në kohën e Enver Hoxhës ishte interesi kombëtar po mos të shaje partinë.

Znj. Çinari: Është para interesave të organizatave apo individëve të veçantë!

Z. Aliaj: Po pra çfarë është interesi kombëtar?

Znj. Çinari: Të eci përpara nisma EITI dhe të mos ngeli peng i inateve personale apo interesave të vogla të organizatave.

Z. Aliaj: Çfarë lidhje ka kjo me interesin kombëtar?

Znj. Çinari: Ka shumë.

Z. Hasanlami: Mos ta kthejmë kështu, mos ta ulim nivelin!

Znj. Çinari: Ilir a ka mundësi të jeni pak më serioz në tavolinë?

Z. Hasanlami: Termin interesa kombëtar e kuptojnë të gjithë. Niveli është më i lartë se aq dhe ai e kërkon kot dhe ti këmbëngul e kundërshton kot!

Znj. Çinari: Jo unë nuk po këmbëngul.

Z. Hasanlami: Pra ai po kërkon kot që ta shtjellosh por edhe ti...

Z. Aliaj Kjo duhet hequr komplet

Znj. Puka: Ecim pak tek pika tjetër.

Z. Hasanlami: Interes Kombëtar është ky, mbarëvatja në të gjithë sektorët që ka target EITI.

Z. Aliaj po të na thuhet

Z. Hasanlami: Ilir mund të futen dy ose tre.

Znj. Puka: Me këto do merremi tani e lagu se lagu?

Z. Arapi: Unë personalisht kam një mendim, për ta hequr fare.

Z. Aliaj: Po pra, edhe unë.

Znj. Çinari: Ky është propozim, doni ta hiqni, hiqeni. Une mendoja se ju keni interes ta shkruani këtë si MSG.

Znj. Puka: Për mua mos të hiqet!

Z. Hasanlami: Jo nuk do ta heqim!

Znj. Hajnaj: Për mua Interesi Kombëtar është Transparenca.

Z. Aliaj: E ka pra Transparencën se e ke në objektiv Transparencën.

Z. Hasanlami: Dorina është në rregull nuk do hiqet!

Z. Spahiu ...*(nuk kuptohet)*

Znj. Puka: Se nuk po e kuptoj tani, këtu thuhet principet e angazhimit të MSG-së. Në MSG kemi edhe bizneset dhe normalisht askush nuk duhet të shikoj vetveten por interesin kombëtar dhe habitem pse doni ta hiqni?

Z. Aliaj: Bravo!

Z. Hasanlami: Dëgjoni, Iliri nuk thotë ta heqim intresin kombëtar por të thuhet dy tre gjëra të thellohet dhe ne e lamë për ta parë.

Z. Arapi: Fjalja që ke thënë ti për Interesin Kombëtar nuk është ajo. Mund ta themi Interesi Kombëtar është në kuadër të Transparencës dhe të rakordimit të të dhënave ndërinstitucionale, bashkëpunimi me shoqërinë civile.

Znj. Çinari: Natyrisht.

Znj. Puka: I ke më poshtë të gjitha këto që po thua.

Z. Aliaj: Ku e ke më poshtë?

Z. Hasanlami: Askush nuk e kundërshton të shënohet Interesi Kombëtar ashtu siç është, ai kërkon të shtohen edhe dy tre fjalë. Dorina, ne i themi dy fjalë se çështë Interesi Kombëtar dhe e mbyllim.

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Z. Neza: Ta riformulojmë këtë. Interesi kombëtar do të thotë në kuptimin që të mbështeten interesat kombëtare më tepër se sa interesat e pjesëshme që burojnë për shkak të përmbajtjes së MSG-së.

Z. Aliaj: Një minutë, se ti që në fillim të dokumentave e ke thënë çfarë është EITI dhe EITI për ne është Transparenca dhe Transparenca për ne do të thotë interes kombëtar, çfarë janë këto?

Znj. Çinari: Si nuk u kuptoka Transparenca Interes Kombëtar? Po bëjmë lojë fjalësh.

Z. Aliaj: Jo nuk po bëjmë lojë fjalësh.

Znj. Çinari: Transparenca është interes kombëtar?

Z. Aliaj: Sigurisht që po.

Znj. Çinari: Transparenca interes kombëtar nënkupton.

Z. Aliaj: Si nuk qënka transparenca interes kombëtar?

Znj. Çinari: Interes kombëtar është edhe zhvillimi i industrive.

Z. Aliaj: Po patjetër, por ti shkruajmë.

Znj. Çinari: Interes kombëtar stimulimi i biznesit.

Znj. Hajnaj: Në kuadrin e EITI-t, se ne jemi në kuadrin e EITI si MSG.

Znj. Çinari: Po.

Znj. Puka: Për angazhimet tona këtu dhe jo për interesin tonë personal, atë ka dashur të thotë autori dhe poshtë keni 12 principet e angazhimit tonë personal se këtu flasim për MSG-në nuk po flasim utopizëm për EITI-n. Secili nga ne këtu përfaqëson interesat e tij dhe interesin kombëtar.

Z. Hasanlami: Principet dhe angazhimet, Interes kombëtar të mbështes interesat e vëndit apo individëve të veçantë. Individëve të veçantë për mua nuk shkon.

Znj. Puka: Vendose fjalën bisneze më mirë ose organizata.

Znj. Çinari: Po nuk është biznes.

Z. Hasanlami: Ka tjetër koncept ai Interesi Kombëtar, çfarë problemi, të mbështesësh këtë apo atë, nuk është ky interesi kombëtar.

Znj. Hajnaj: Mund të themi diçka se ne këtu kemi një detyrë për të mbështetur EITI-n dhe mund ta themi Interesi Kombëtar të mbështesim procesin EITI për Transparencën e plotë të gjithë institucioneve publike dhe private.

Z. Hasanlami: Bukur dhe e mbyllim, nuk kemi individë. Shënoje Dorina aty që kalon. Në rregull!

Z. Aliaj : Interesi kombëtar për shumë njerëz është biznesi i tij dhe personi i tij, ju kujtoni se është shoku Enver.

Z. Hasanlami: Dorina, kalojmë te shtata, u mbyll ajo.

Znj. Çinari: Përbërja.

Z. Hasanlami Përbërja, kryesohet nga zv. Ministri, përfaqëson institucione dhe agjencitë shtetërore..pse e kundërshton Ilir këtë? Pse duhet të hiqet paragrafi?

Z. Aliaj: Kjo është thjesht postim se nuk ka ndonjë gjë këtu tek kjo, është pak më vonë por gjithësesi meqë u hap kjo histori, të hiqet paragrafi i mëposhtëm them unë se nuk e ka vëndin aty, MSG-ja Shqiptare ka në përbërjen e saj, përfaqësues si të thuash të këtyre grupimeve dhe këtu përshembull tek pika c, shoqëria civile Shqiptare e cila në të vërtetë mund të përfaqësohet në MSG nëpërmjet grupimeve të pavarura...

Z. Hasanlami: Pika c?

Z. Aliaj: Po c. E gjetët?

Znj. Çinari: Po bëni propozim se dhe nuk mund të jemi dakort.

Z. Aliaj: Po propozim. Me bazë të gjërë të shoqërisë civile, të përfaqësuesve të medias, botës akademike apo sindikatave. Këtu dua të ndalem, ne jemi pesë veta të zgjedhur. Tani kemi një vendim të Këshillit të Ministrave që është baza ligjore 21.07.2011 dhe ky vendim thotë nga institucionet publike kaq, nga biznesi kaq dhe nga shoqëria civile kaq. Ne nuk mund të dalim ligjërisht mbi një Vendim të Këshillit të Ministrave.

Znj. Çinari: Jeni dakort Ilir që t'ju vinte një vendim i draftuar në tavolinë? Se do thoni nuk na pyetët.

Z. Aliaj: Po një minute Dorina, ne po diskutojmë.

Znj. Çinari: Po t'ju kishte ardhur një vendim këtu në tavolinë, të kishte ardhur një urdhër i ri i Kryeministrit do kishte thënë nuk na pyetët. Unë këtë po them që këtu keni një propozim dhe a jeni dakort apo jo dhe mbas kësaj shkohet dhe bëhet Urdhër Kryeministri.

Z. Aliaj: T'jua sqaroj deri në fund dhe pastaj më kthe përgjigje.

Z. Spahiu: Me sa kuptova Urdhëri i Kryeministrit inicohet nuk është se është i pandryshueshëm.

Z. Arapi: Tani më falni ky dokument këtu do dali si VKM?

Znj. Puka: Atëhere unë propozoj diçka, duke qënë se ky do jetë një dokument që do jetë i gjallë *(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)*

Znj. Çinari: Ne nuk po rrisim numrin, ne po propozojmë shtatë, mund të propozojmë dhe pesë.

Z. Hasanlami: Për pjesën institucionale ai është dakort, të gjithë jemi dakort, tek pjesa e shoqërisë civile, se aty po diskutoni ju pjesa, e shoqërisë civile.

Znj. Puka: Po duhet të jetë balancë 7-7-7 ose 5-5-5!

Znj. Çinari: Standarti e thotë jo domosdoshmërisht me numër të barabartë.

Z. Neza: Ka dy momente, momenti parë është, pjesa ligjore u sqarua, kjo do jetë propozim që do i bëhet Këshillit të Ministrave, Kryeministrit për tu bërë si vendim. Dhe e dyta është numri, jeni dakort me numrin? Unë them nuk ka ndonjë problem, numri me 7. Problemi që kam ngritur unë është problemi i ndarjes. Ndarja më duket e pa nevojshme!

Znj. Çinari: Si ta sygjeroni ju...

Z. Hasanlami: Sami, ndarja mes shtatesh?

Z. Neza: Po, më duket e pa nevojshme.

Z. Hasanlami: Konkretisht?

Z. Neza: Në vënd që të thuhet 4+2+1, përfaqësues të shoqërisë civile, komunitetit dhe sindikatave si dhe akademikëve e lëmë të hapur. Sepse unë dhe Iliri jemi dhe pedagog.

Znj. Çinari: Kjo është si ta sygjeroni ju.

Z. Arapi: Unë jam thjesht për ti hequr ndarjet 4+2+1.

Z. Aliaj: Këtë po thotë.

Z. Arapi: Nuk ka nevojë e gjejnë vet me njëri- tjetrin. Ne themi të vinë nga kush të dojë.

Z. Neza: Mund të hedhësh në garë 10 akademik dhe nuk fiton asnjëri, si do ja bësh?

Z. Spahiu: Unë personalisht jam dakort që të zgjidhet në mënyrë të lire sepse nëse ti do thuash që do prezencë akademike do thuash...

Znj. Çinari: Me kuotë. Po atë duhet ta ketë parasysh shoqëria civile.

Znj. Hajnaj: Jo jo, Ne këtu i zgjedhim vetë dhe nuk keni pse ndërhyini. Ata të dy akademik janë ata, profesor janë ata.

Znj. Çinari: Jo, akademik është diçka tjetër!

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Znj. Çinari: Përparim, a kemi qënë bashkë në në takime, ku pedagogët e universitetit na kanë thënë që ne kemi shumë dëshirë të jemi pjesë e asaj tavoline dhe si të afrohemi? Janë thjeshtë pedagog në universitetin e minierave.

Z. Spahiu: Unë them ta detajoni.

Znj. Hajnaj: Nuk ka pse të detajohet fare. Ajo formula duhet të hiqet, ne e kemi parasysh që duhet të sjellim në tryezë cilësi dhe pastaj zgjedhjet i bëjmë vetë.

Z. Hasanlami: Jo, nuk është ashtu ajo.

Znj. Hajnaj: Është ai propozimi që tha ai të përmenden por jo me formulë. Të përmendet që duhet të jenë këto dhe këto.

Znj. Çinari: Si ta mendoni ju!

Znj. Hajnaj: Jo jo. Grupin e shoqërisë civile ti nuk ma përcakton dot mua!

Z. Aliaj: Dritan, edhe mediat janë shoqëri civile, edhe akademikët janë shoqëri civile dhe ti nuk mund ti thuash dhe nuk mund ti ndash me thikë.

Znj. Hajnaj: Se ai që është pedagog nuk mund të marrë pjesë si shoqëri civile nëse nuk është pjesë e një organizate.

Z. Aliaj: Jo jo.

Znj. Hajnaj: Po pse jo?

Znj. Puka: Hiq priftin dhe administratën të gjithë të tjerët janë shoqëri civile.

Z. Aliaj: Fjala shoqëri civile ju përmbledh edhe juve jashtë punës sepse ke opinion civil për problem të ndryshme të shoqërisë Shqiptare

Znj. Çinari: Edhe ne të dyja jemi shoqëri civile pas pune.

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Z. Arapi: Nëse e heqim këtë formulën ka problem?

Znj. Çinari: Asnjë problem, shoqëria civile duhet tek shënimet e veta, kodet e veta duhet ta shënoj 1,2,3!

Z. Neza: E shënojmë që duhet tek ky draft që është!

Znj. Hajnaj: E kemi.

Znj. Çinari: Ku e keni Anila? Ecim zgjedhja e përfaqësuesve e lamë apo e hoqëm?

Znj. Hajnaj: Formula u hoq përmëndja le të jetë.

Z. Hasanlami:Një sekond përse u hoq formula?

Z. Aliaj: Më falni, duhet të jetë thjesht shoqëri civile pse e hiqni akademikun nga shoqëria civile?

Znj. Hajnaj: Atëhere e lëmë vetëm shoqëria civile, përfaqësues të shoqërisë civile.

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Z. Arapi: Ilir nuk jam dakort, se e bëjmë më shumë të kuptueshme shoqëri civile, akademik, le të jetë.

Z. Aliaj: Azbi i ke, janë të gjithë shoqëri civile.

Z. Arapi: Dorina vetëm numrat të hiqen dhe as një pjesë tjetër!

Z. Alikaj: Po numrat, me këtë jam dakort edhe unë.

Z. Aliaj: Shumë mire.

Znj. Puka: Kam edhe unë një koment të lutem. Përfaqësues nga shoqëria civile të përzgjedhur nga grupime kombëtare të shoqërisë civile. Çfarë keni dashur të thoni me fjalën grupimi kombëtar i shoqërisë civile?

Znj. Çinari: Kz është përkthimi/formulimi pikë për pikë nga standarti EITI, kështu thotë.

Z. Aliaj: Po në rregull, ke rrjetin kombëtar.

Znj. Puka: Rrjetin e kujt kombëtar? Të kujt?

Z. Aliaj: Të EITI-t Medlin.

Znj. Çinari: Grupimet Kombëtare, grupimet mund të jenë disa, mund të jetë një.

Znj. Puka: Mund të jenë të ndryshme.

Znj. Çinari: Po sigurisht.

Z. Hasanlami: Dorina, po u bënë dhjetë grupime, ai 10 organizata, ai tjetri 10 organizata...

Z. Spahiu: Këtu janë shtatë.

Znj. Çinari: Do zgjidhen këta, i bëjnë vet zgjedhjet këta.

Z. Spahiu: Ku, kush do i koordinojë?

Znj. Hajnaj: I koordinojmë vetë ne, kemi koalicion.

Znj. Puka: Duhet të kemi parasysh që sot për sot në Shqipëri, ka grupime nga më të ndryshmet, mund të ketë për gender-in, gratë, mjedisin.

Z. Hasanlami: Po pra.

Znj. Hajnaj: Po duhet shënuar ata që janë të përfshirë në këtë. Se nuk mund të marësh organizatë kalamajsh ti tani dhe të vij këtu. Ne kemi kritere kush futet në koalicion.

Znj. Çinari: Pse jo? Mund të mbështesin fëmijët në nevojë në zonën e Bulqizës.

Z. Spahiu: Unë them që të rritet numri.

Z. Hasanlami: Dorina ti si mendon?

Znj. Çinari: Ky është propozim, mendimi këtu ka qënë që ti jepet mundësia grupimit të paraqitet, nuk e duan kështu...

Znj. Puka: Kjo e imja ishte pyetje, se po të jetë për mua për të shtuar, unë nuk merrem me 4+2+1, por them nga gjithë zonat gjeografike ku është industria nxjerrëse sepse ti më sjell mua këtu të gjitha burimet kombëtare që kanë qëndër në Tiranë dhe ec e merre vesh se çfarë ndodh në Bulqizë dhe se çfarë përfaqësimi ka.

Znj. Çinari: Kush i sjell?

Znj. Puka: Ta zëmë shoqëria civile, siç ka qënë deri tani, të paktën 5 vite të treja organizatat që kanë qënë në Tiranë dhe deri sa të ishin përfaqësues këtu ka qënë bunker, tani shënoje dhe këtu që duhet të ketë përfaqësi edhe sipas zonave gjeografike të ndryshme.

Znj. Çinari: Ku?

Znj. Puka: Tek pika 7.

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Znj. Çinari: ...dhe me shpërndarje gjeografike.

Znj. Hajnaj: Po po.

Znj. Puka: Me përfaqësi gjeografike.

Z. Hasanlami: Vazhdojmë! Iliri thotë këtu është bërë një lapsus me përfaqësuesit e biznesit, tek teta.

Znj. Çinari: Zgjedhja e antarëve

Z. Aliaj: Jo, u sqarua kjo histori.

Z. Hasanlami: Ok, u mbyll.

Znj. Hajnaj: U hoq formula.

Z. Hasanlami: Kalojmë, jemi tek teta.

Z. Aliaj: Tek 9-ta. Me fal një minute.

Z. Hasanlami: A the u sqarua tani?

Z. Aliaj: U ngatërrova.

Znj. Çinari: Pika a. është zgjedhja.

Z. Aliaj: Pika poshtë.

Znj. Çinari: Është zgjedhja e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore.

Z. Aliaj: Zgjedhja e antarëve të MSG-së.

Znj. Çinari: Po, pika a. zgjedhja e përfaqësuesve të organeve shtetërore, do të emërohen nga titullarët e institucioneve të tyre, 15 ditë mbasi i dorëzohet kërkesa secilit institucion.

Znj. Puka: Shumë mire ishte.

Znj. Çinari: Përfaqësimi në MSG nuk është nominal por lidhet me detyrën që mban personi i emëruar pranë institucionit që përfaqëson.

Z. Alikaj: Patjetër.

Z. Hasanlami: Nuk ka problem, pse po e lexon?

Znj. Çinari: Jam këtu, pika 8 a.

Z. Hasanlami: E kaluam.

Znj. Çinari: Pika b. pjesëmarrja në MSG për përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e biznesit me qëllim mundësimin me përfaqësimin me bazë të gjerë bëhet me ftesë të hapur publike nga Kryetari i këtij grupi pune dhe administrohet në mënyrë të pavarur dhe transparente nga secili grupim. Pikë për pikë sipas standartit EITI. Secili nga grupimet duhet të bëjë transparente procedurën e përzgjedhjes, duhet të dokumentojë në mënyrë të plotë pranë Kryetarit të MSG-së procesin dhe procedurën e përzgjedhjes, vleshmërinë e mandatit të çdo anëtari. Sekretariati EITI Albania do të ofrojë mbështetje teknike përgjatë procesit të përzgjedhjes në rast se kjo gjë kërkohet nga ndonjë nga grupimet. Sekretariati EITI Albania si përfaqësues i shtetit Shqiptar që ka angazhimin zyrtar në procesin EITI ka në çdo rast të drejtën të observoj procesin e zgjedhjes së antarëve të MSG-së nisur nga nevoja për të përmbushur nevojën e interesit kombëtar për të mirën e vendit si vend zbatues EITI dhe ruajtjen e këtij statusi para intresave dhe grupimeve të individëve të veçantë.

Z. Hasanlami: Vetëm nuk e kuptova pse na e lexove?

Znj. Puka: Po bizneset si i zgjidhni ju, se bizneset janë një grupim që si keni prekur?

Znj. Hajnaj: Po edhe ne vendosim vetë.

Znj. Çinari: Me ftesë të hapur publike.

Znj. Hajnaj: Po edhe ne vendosim vetë.

Znj. Çinari: E ke të shkruar Anila.

Znj. Hajnaj: Jo, ke bërë ftesën e hapur publike ë Kryetarit grupit të punës.

Znj. Çinari: Po, ai bën ftesë të hapur publike.

Z. Spahiu: Po pastaj si zgjidhen këta vetë, me short?

Znj. Hajnaj: Grupit të punës së shoqërisë civile.

Znj. Çinari: Pastaj, administrohet në mënyrë të pavarur dhe transparente nga secili grupim. Zoti Bejtja thotë ftesë të hapur publike për gjithë shoqërinë civile Shqiptare që ka fokus në EITI.

Z. Aliaj: Jo jo.

Z. Hasanlami: Po dikush duhet ta bëjë ftesën.

Z. Arapi: Si e ka standarti EITI?

Z. Aliaj: Standarti e ka komplet ndryshe.

Znj. Çinari: Shteti Shqiptar me ftesë të hapur publike për të gjitha grupet e interesit, hapeni standartin, lexojeni!

Znj. Hajnaj: Po kjo është kur fillon Dorina.

Znj. Çinari: Po tani ku jemi? Kemi bërë ftesë të hapur publike ndonjëherë ne Anila?

Znj. Hajnaj: Po është bërë në fillim.

Znj. Çinari: Ftesë publike?

Znj. Hajnaj: Po.

Znj. Çinari: Nuk ka asnjë dokument që ta provoj këtë.

Znj. Hajnaj: Nuk e di unë ka apo nuk ka dokument...

Z. Hasanlami: Po çfarë na prish punë kjo njëherë?

Znj. Hajnaj: Ne jemi në mes të rrugës dhe duhet ta shohim pak më ndryshe këtë sepse ne kemi një mandat 3 vjeçar.

Znj. Çinari: Atëhere secili nga grupimet duhet të bëjë transparente procedurën e përzgjedhjes, të dokumentoj mënyrën e plotë, procesin, procedurën dhe vlefshmërinë e mandateve, sa legjitim ishte procesi.

Znj. Hajnaj: Dakort, jam shumë dakort por ftesën nuk mund ta bëj. Ose të biem dakort këtu se si do të bëhet ftesa sepse ne kemi një mandat 3 vjeçar që përfundon kur na përfundon. Atëhere si do bëhet, mua më mbaron mandati.

Znj. Çinari: Si do bëhet?

Znj. Hajnaj: Ne si shoqëri civile do bëjmë ftesën duke informuar edhe MSG-në që ne po bëjmë ftesë që kush do, se ne kemi një proces të hapur të zgjedhjes në MSG.

Znj. Çinari: Ne duhet të vendosim disa check and balance se si, që të sigurohemi që procesi është i hapur dhe transparent.

Znj. Hajnaj: Po po.

Znj. Çinari: Po ti jepet mundësi të gjithëve.

Znj. Hajnaj: Po sigurisht, patjetër.

Znj. Çinari: Dhe formuloheni ju si e doni, por procesi duhet të dokumentohet.

Z. Hasanlami: ...

Znj. Çinari: Sepse është detyrim i shoqërisë civile ta menaxhoj vetë procesin.

Z. Hasanlami: Procesin e vet?

Znj. Çinari: Po, por të sigurohet që ky proces është i hapur dhe shumë transparent dhe i është dhënë mundësia të gjithëve të përfaqësohen.

Znj. Hajnaj: Shumë dakort.

Z. Arapi: Dorina unë propozoj, që për pjesëmarrjen të bëhet një ftesë e hapur nga Kryetari i këtij grupi pune dhe kjo fjali të hiqet, Kryetari i grupit të punës.

Z. Spahiu: Po pse nga kush?

Znj. Çinari: Po kush duhet ta bëjë?

Z. Arapi: Ta mbaroj pak ju lutem, mendimi juaj është ndryshe por kjo nuk do të thotë që çfarë thotë Dorina apo Iliri unë do mbështes këto. Unë kam mendimin tim pastaj .

Znj. Çinari: Po, mbarojeni ju lutem.

Z. Arapi: Referuar edhe asaj që ishim në Peru, të drejtat që kërkon shoqëria civile, ne e dimë shumë mire se si ka filluar të ndihet shoqëria civile edhe të futet në familjet shqiptare, se çfarë do të thotë shoqëria civile. Që edhe në momenti kur del, nuk të lë njeri këtu sepse vjen ai dhe sa ta kapi shoqëria civile, vjen ...të kap urgjent dhe thotë jam unë këtu. Normalisht, siç ti do ti kërkosh institucioneve që do të riformatohen MSG, AKBN, Shërbimi Gjeologjisë dhe gjithë këtyre i dërgohet edhe një shkresë nga kryetari i MSG-së përfaqësuesve të shoqërisë civile.

Znj. Çinari: Kush janë këta?

Z. Arapi: Ju lutem ta përfundoj mendimin, nga Kryetari i MSG-së që merr mendim nga ne antarët e MSG-së i bën një ftesë shoqërive civile, ftesat janë transparente sot, bëhen në media një dhe në gazetatat e pavaruara dy. I dërgon njoftimet zyrtare edhe thotë EITI...në fund fare do themi për transparencën dhe funksionimin e shoqërisë civile EITI krahas gjithë kontrolleve të tjera që bëhen në rangun kombëtar dua të të asistoj..që të shohim edhe transparencën se si po zhvillohet zgjedhjet në shoqërinë civile për përfaqësuesit e MSG-së. Ky është mendimi im se ka njerëz që nuk shprehin interes dhe nuk duan të vinë dhe unë me zor nuk i marr.

Z. Aliaj: Ajo mund të jetë me propozim të shoqërisë civile që është këtu.

Znj. Hajnaj: E hapur në tryezë, e diskutuar në tryezë dhe mund të publikohet në faqen e EITI-t.

Z. Hasanlami: E nisi Iliri mirë.

Z. Aliaj: Me propozim të shoqërisë civile që është pjesë e MSG-së me miratim të MSG-së ku është edhe Kryetari pjesë.

Znj. Hajnaj: Të publikohet në faqen e EITI-t.

Z. Aliaj: Të bëhen ftesat kur të jetë koha, a jeni dakort apo jo?

Z. Hasanlami: Dakort, por këtë ftesën kush do ta bëj?

Z. Arapi: Kryetari i MSG-së.

Z. Hasanlami: Kryetari i MSG, dakort.

Znj. Hajnaj: Jo jo as kështu, do të jetë në faqen e Sekretariatit EITI, shoqëria civile do të bëj zgjedhjen.

Z. Shehu: Të përcaktohet të lidhur me çështjen EITI sepse këta janë një grupim të lidhur me këtë çështje.

Z. Neza: E ke tek standarti EITI. Dorina është tek Standarti.

Znj. Çinari : Cila?

Z. Neza: Personat e shoqërisë civile ose organizatat e shoqërisë civile, akademikët etj. duhet të kenë një lidhje me industrinë nxjerrëse. Çfarë do të thotë që mund të jenë nga komunitetet ku ka industri nxjerrëse, mund të jenë nga sindikatat e punëtorëve, nga organizata të shoqërisë civile ku e ndërtojnë punën në këto zona, e ka standarti EITI pikë më pikë këtë të shoqërisë civile, thotë të lidhur me njohuri për industrinë nxjerrëse dhe të lidhur në këtë interes

Znj. Hajnaj: Jua sjell formulimin e plotë ashtu siç e ka standarti, jeni dakort?

Znj. Çinari: Të kujt pike ?

Znj. Hajnaj: Të pikës për ne, shoqëria civile që është e lidhur dhe ka edhe eksperiencë në këtë. Dhe e dyta është që ne në momentin që do na mbaron mandati dhe do bëjmë zgjedhjet, ne do informojmë MSG-në, kjo mund të futet në faqen e Sekretariatit që shoqëria civile ka hapur këtë procedurë përzgjedhjeje dhe ne do të hapim një faqe webi të koalicionit të EITI-t dhe do të jetë e publikuar, jeni dakort?

Znj. Çinari: Anila formulojeni paragrafin.

Znj. Hajnaj: Do ta formulojmë dhe do jua dërgojmë.

Z. Aliaj: A ka mundësi?

Z. Hasanlami: Ilir, çfarë?

Z. Aliaj: Po dakort ta formuloj dhe ta nisi me email.

Z. Hasanlami: Shumë në rregull kalon me këtë formulimin që do bëjnë.

Z. Aliaj: Dakort.

Znj. Çinari: Keni pikë tjetër për koment, mandatet dhe zëvendësimi?

Znj. Hajnaj: Ku është mandate dhe zëvendësimi?

Znj. Çinari: Pika 9.

Znj. Hajnaj: Diçka lexova unë këtu, mandati i përfaqësuesve, 3 vjet ata do kenë mandate por ne kemi vënë re që kur bëhet ndryshim i pushteteve vinë të tjerë persona. Tani kemi Azbiun, ja u ndryshua pushteti Azbiu nuk do jetë më po ka mandate tre vjeçar apo do qëndroj detyrueshëm këtu edhe pa qënë në pozicionin.

Znj. Puka: Është e thënë në fillim që nuk është nominative në institucione, është e qartë kjo gjë.

Z. Aliaj: Këtu nuk ka ardhur si përfaqësues i partive politike...

Z. Hasanlami: Anila, ka një të drejtë dhe absolutisht Azbiu dhe unë dhe Iliri jemi këtu për efekt të pozicionit..

Z. Aliaj: Jo jo, ju jo edhe Azbiu, Zv/Ministri po.

Z. Hasanlami: ...automatiksht nëse s'jemi drejtorë ikim në punën tonë.

Z. Aliaj: Jo jo e ke gabim.

Znj. Çinari: Jo nuk e ka gabim ashtu është. Është i lidhur me rolin që kanë në këtë moment.

Z. Hasanlami: Ashtu është.

Z. Aliaj: Nuk është rol politik ai.

Z. Hasanlami: Unë për momentin e zëmë më cakton institucioni, mbyllet nuk jam i zgjedhur.

Z. Aliaj: Dakort, por ti nuk je politik në vëndin e punës.

Znj. Çinari: Është i emëruar.

Z. Hasanlami: Mandati i këtyre që janë nga ministria, institucioni bie direkt në momentin që nuk është më.

Znj. Hajnaj: Po mirë thuhet që do të ndryshoj këto njëherë në tre vjet, kush do të ndryshojë, do ndryshoj pozicioni?

Znj. Çinari: Anila e ke më poshtë flet për dy grupimet e tjera.

Z. Hasanlami: E ke për grupimet, kjo është shumë e qartë ne kot po bëjmë debat sepse kjo është e qartë.

Znj.Puka: Po pra kjo është e qartë.

Znj. Hajnaj: Por mirë nëse këta të dy kanë mandate përse duhet përcaktuar mandati atëhere, ne e kemi që e kemi tre vjeçar dhe nuk është e rëndësishme ta shkruani fare ju këtë.

Z. Hasanlami: Mund të rizgjidhesh.

Znj. Hajnaj: Sipas kodit të zgjedhjes të shoqërisë civile.

Znj. Çinari: Sipas standartit.

Znj. Hajnaj: Sipas standartit ne e kemi tre vjeçar standartin.

Z. Aliaj: Anila nuk thuhet sipas kodit, është standart tjetër kund nuk është kodi ynë.

Znj. Hajnaj: Po mirë sipas standartit.

Znj. Çinari: Duhet ta përcaktoj MSG-ja, ka detyrimin ta përcaktoj kohën e mandatit të çdo anëtari, kohën e rifreskimit të mandatit dhe afatin se sa mandate mund të ketë, e keni të shkruar në standart.

Znj. Hajnaj: Po vetëm për dy grupime dhe jo për antarët.

Znj. Çinari: Neve jemi të zgjedhur si mbas pozicionit që mbajmë, nuk është nominal emërimi ynë.

Znj. Puka: Tani ju këtu keni dhe një kontradiktë tjetër.

Znj. Çinari: Po, thuaje!

Znj. Puka: Se thoni vlerësimi do jetë vjetor, në momentin që performanca është më e ulët se 60 përqind atëhere duhet të zëvendësohet.

Znj. Çinari: Po.

Znj. Puka: Në një vend thoni 3 vite, ose qëndroni sipas vlerësimeve.

Znj. Çinari: Mandati për një përfaqësues, ky është propozimi. Mandati për një përfaqësues është 3 vjet. Në fund të një viti bëhet vlerësimi i performancës dhe ju vazhdoni automatikisht rolin tuaj. Nëse nuk keni bërë asgjë gjatë një viti duhet të zëvendësohet.

Znj. Hajnaj: ...

Znj. Çinari: Kërkohet nga të gjithë partnerët Anila.

Z. Aliaj: Kaluam një pikë.

Z. Hasanlami: Të bëj një pyetje konkrete ju lutem. Tani ju thoni këtu...

Z. Aliaj: Te cila pikë je?

Z. Hasanlami: Jemi te pika 11 tek materiali yt, te pika 9 e materialit.

Z. Aliaj: Flasim pak për më sipër se nuk e shqyrtuam.

Z. Hasanlami: Një sekond, marrim këtë që mos ta marrim më dy herë.

Z. Aliaj: Po.

Z. Hasanlami: Antarët kanë të drejtë të riemërohen edhe për një mandatë të dytë.

Znj. Çinari: Po.

Znj. Hajnaj: Në rregull edhe ne ashtu e kemi në grupimin tonë.

Z. Hasanlami: Ndryshe është pjesa e formuluar nga Dorina por aty aty janë.

Znj. Hajnaj: Pse si është e formuluar nga Dorina? Edhe pika e Dorinës ashtu është.

Z. Hasanlami: Pika 9 e draftit dhe pika 11 e Ilirit. Kush do ta riemëroj, Ilir se këtu del e paqartë?

Z. Aliaj: Do ta emëroj grupimi, grupi që përfaqëson.

Z. Hasanlami: Një sekondë Iliri, thotë të hiqet kjo grupimi dhe të shkruhet mund të emërohen nga grupimet e tyre.

Z. Aliaj: Po.

Znj. Puka: Ndërkohë që ne deri në dy mandate e kemi që duhet zgjedhur, 6 vjet, më shumë se 6 vjet nuk mund të jesh antar i MSG-së.

Z. Hasanlami: Dorina shto edhe ato grupimet e tyre në fund dhe mbyllet

Znj. Çinari: Po normale, ne e kemi shkruar më sipër.

Z. Aliaj: Jo shkruaje të lutem!

Z. Hasanlami: Të hiqet ajo aty sipër dhe të vihet në fund.

Znj. Çinari: Dhe mund të riemërohen nga përfaqësuesit e grupit të tyre. Unë nuk e di çfarë kërkoni ju se është e shkruar e zeza mbi të bardhë?

Znj. Hajnaj: Po unë e pashë që ishte kjo.

Z. Hasanlami: Antarët kanë të drejtë të riemërohen edhe për një mandat të dytë, ky e ka këtu nga përfaqësuesit e grupit të tyre.

Znj. Çinari: E ke të shkruar.

Znj. Hajnaj: Ja ku është në paragrafin e dytë, në mes.

Z. Hasanlami: Tani ka edhe një gjë tek performanca, mund të jetë e drejtë, kush do e vlerësoj performancën?

Z. Aliaj: Kush do e vlerësojë performancën?

Znj. Çinari: E vlerësoni ju, ky është një propozim.

Z. Hasanlami: Ndoshta unë nuk jam asnjëherë dakort me udhëheqjen e grupit dhe unë do të thotë që performoj keq? Tani kush duhet ta vlerësoj këtë performance?

Znj. Çinari: Kjo do përcaktimet tani.

Znj. Hajnaj: E vetmja gjë për matjen e performances është pjesëmarrja.

Z. Neza: Keni shkuar te kjo, nuk kemi shkuar akoma.

Z. Aliaj: Kemi një pikë që e kemi kapërcyer.

Znj. Çinari: Ju që nuk dokumentoni asnjë veprimtari gjatë vitit është performancë.

Znj. Hajnaj: Çfarë veprimtarie?

Znj. Çinari: Ju si veprimtari, si shoqëri civile sepse ka një rol shoqëria civile në tavolinë, nuk vjen kot.

Znj. Hajnaj: O kemi qënë ne aktiv këtu, o nuk ka qënë njeri.

Znj. Çinari: Po jo vetëm këtu Anila, se ka një rol shoqëria civile është communication outreach nuk është me ardh në tavolinë. Shoqëria civile ka rolin e vetë të penetroj në shoqëri.

Znj. Hajnaj: Ne kemi rolin tonë të penetrojmë, po është e vërtet.

Znj. Çinari: Kur ju keni aktivitet dokumentohet dhe ai është aktiviteti juaj.

Znj. Hajnaj: Në rregull, por ne nuk po themi për këto gjëra ne po themi...

Znj. Çinari: Po çfarë po themi?

Znj. Hajnaj: Jo nuk po flasim për këtë gjë, se di ku më poshtë lexova...

Z. Aliaj: Mos kalojmë pikat, ju lutem, keni kaluar pikat.

Z. Arapi: Kthehemi pak mbrapa tek pika ku thotë Iliri.

Z. Aliaj: Tek pika 8 ose pika 10 e komentit që kam bërë unë. Nën pika d. thotë Sekretariati AlbEITI si përfaqësues i shtetit ka angazhim zyrtar në procesin EITI, ka në çdo rast të drejtën të observoj procesin e zgjedhjeve të antarëve të MSG-së nisur nga nevoja për të përmbushur interesin kombëtar.

Znj. Çinari: Po, ku është?

Z. Aliaj: E ke tek pika 8 d. e draftit që na është sjellë, faqe 6, e gjete?

Znj. Çinari: Po.

Z. Aliaj: Ne folëm për këtë çështjen e interesit kombëtar.

Znj. Çinari: Po.

Z. Aliaj: Kështu që duhet ndryshuar.

Znj. Çinari: Interesi kombëtar në këtë rast mund të jetë validimi. Proçesi i validimit do të kërkoj të ketë një legjitimitet zgjedhja e çdo antari të MSG-së. Deri më sot nuk është dokumentuar asnjë gjë se si është bërë përzgjedhja e antarëve të MSG-së.

Z. Aliaj: Po çlidhje ka me interesin kombëtar kjo?

Znj. Çinari: Sepse është Qeveria Shqiptare ajo që është në EITI, nuk është shoqëria civile shqiptare antare në EITI.

Z. Aliaj: Çfarë është Qeveria Shqiptare?

Znj. Çinari: Qeveria Shqiptare, është Kryeministri i Shqipërisë, është Shqipëria dhe është qeveria që ka shprehur angazhimin për të qenë pjesë e EITI-t.

Z. Aliaj: Po shumë mirë.

Znj. Çinari: E mban përgjegjësinë Ministri i Energjisë, Kryeministri edhe unë pastaj. Në këtë rrethanë kur të vij Validimi dhe për x arsye të gjykohet që nuk është plotësuar procesi.

Z. Aliaj: Po.

Znj. Çinari: Ne të jemi në gjëndje të themi që ne e kemi observuar procesin dhe është sipas standartit. Pra është dokumentuar, është legjitim, është transparent dhe kush është problemi me qënë transparent?

Z. Aliaj: Nuk ka lidhje me transparencën.

Znj. Çinari: Po kush është që nuk ju pëlqen?

Z. Aliaj: Shkruaje transparencë por interesi kombëtar, shkruaje transparencë

Znj. Çinari: Interesi kombëtar është që...

Z. Aliaj: Shkruaje transparencë!

Znj. Çinari: Shqipëria është antare në EITI.

Z. Aliaj: Po shumë mirë.

Znj. Çinari: Nëse down graded Shqipëria...

Z. Aliaj: Edhe unë bashkë me të, edhe ti, të gjithë ne me radhë.

Znj. Çinari: Ti do vazhdosh me një projekt tjetër.

Z. Aliaj: Po nuk ka rëndësi.

Znj. Çinari: Si përfundim ...është i Shqipërisë, ky është interesi kombëtar

Z. Aliaj: Ti mendon që e do Shqipërinë më shumë se unë?

Znj. Çinari: Jo jo.

Z. Hasanlami:Një sekondë ta sqarojmë.

Znj. Çinari: Është qeveria shqiptare që mban përgjegjësinë.

Z. Aliaj: Qeveria shqiptare jam edhe unë.

Znj. Çinari: Jo nuk je, je shoqëria civile.

Z. Aliaj: Po jam sepse jam i interesuar që qeveria shqiptare të shkojë mirë.

Znj. Çinari: Je shoqëria civile more Ilir.

Z. Aliaj: Po kur vjen puna për interesin si më hiqte ti nga qeveria shqiptare?

Znj. Çinari: Kur vjen puna për interesin kombëtar çon emaile personale.

Z. Aliaj: Po sigurisht që do çoj, do ju pyes ju?

Z. Hasanlami: Ju lutem, kur të pini kafen bisedojini këto!

Znj. Çinari: Jepeni, propozimin tani Ilir!

Z. Aliaj: E dhashë propozimin.

Z. Hasanlami: Këtu nuk del e qartë realisht që ka të bëjë me OJQ-në që përfaqëson Iliri apo me Ilirin. Se këtu thotë përfaqësuesi nuk ka performancë të qartë, si ta lëmë këtë, ta lëmë kështu?

Znj. Çinari: Po thotë për këtë në pikën d. Këtu.

Znj. Puka: Tani unë parimisht, çdo lloj zgjedhje ka nevojë për vëzhgim kështu që nëse Sekretariati vjen e vëzhgon unë nuk e kam problem fare.

Z. Aliaj: Ti shumë mirë që se ke problem, ti je shumë transparente.

Znj. Puka: Po.

Z. Aliaj: Unë po them togfjalëshin interesi kombëtar.

Znj. Puka: E sqaruam radhën e parë atë togfjalëshin atje do ta rregullojmë edhe këtu.

Z. Aliaj: Po këtë po them.

Znj. Çinari: Interesi kombëtar është Shqipëria antare në EITI, ky është interesi kombëtar.

Z. Hasanlami: Kalojmë tek 12 Anila.

Znj. Hajnaj: Për të përmbushur transparencën e këtij procesi, e lëmë kaq.

Znj. Puka: Unë them të hiqet pika d. e gjitha.

Znj. Hajnaj: Për të përmbushur transparencën e procesit e lëmë.

Z. Aliaj: Po fiks.

Znj. Çinari: Po pse është kaq e vështirë me thënë Shqipëria vend antar në EITI? Pse duhet t'ju dhëmbi kaq shumë?

Z. Aliaj: Nuk na dhëmb aspak.

Znj. Çinari: Po atëhere?

Z. Aliaj: A jemi për ta diskutuar këtë draft apo nuk jemi për ta diskutuar këtë draft?

Znj. Çinari: Po kam mendimin tim Ilir, po mbroj mendimin tim.

Z. Aliaj: Po shumë mirë, nuk po them mos diskuto.

Znj. Hajnaj: A e lëmë kështu tani, për të përmbushur transparencën e procesit?

Pjesa më e madhe përgjigjet dakort!

Znj. Hajnaj: Çfarë ka tjetër tani?

Znj. Puka: Zëvendësimi i antarëve.

Znj. Hajnaj: Edhe neve e kemi përcaktuar zëvendësimin e antarëve se si do bëhet.

Z. Aliaj: Pikën 11 ose 9 e diskutuam.

Z. Arapi: Jemi në rregull me atë.

Z. Hasanlami: Ilir, maksimumi këtu mund të përcaktohet një raport midis grupit që përfaqëson dhe personit që përfaqëson.

Z. Aliaj: Ju e thatë shumë mire.

Z. Hasanlami: Pra këtu mund të vendoset në sensin se ndoshta ai përfaqësuesi përshëmbull është shumë i mirë por ata çfarë ka mbrapa nuk bëjnë por mund të jetë organizata shumë e mirë dhe përfaqësuesi shumë i keq dhe performancat i ka. Do bëjmë një korrëgjim të përfaqësuar dhe përfaqësuesit këtu.

Znj. Çinari: Sigurisht, propozoni!

Z. Spahiu: Të them diçka, se ai është i zgjedhur se kur shkon deputet në parlament nuk e heq dot.

Z. Hasanlami: Mund të jetë edhe idiot ai.

Z. Spahiu: Mund të jetë idiot por nuk e heq dot.

Z. Aliaj: Kush e përcakton atë? E heq pas katër vjetëve vota e popullit.

Znj. Çinari: Po kush popull voton për ju Ilir?

Z. Aliaj: Ai populli që ishte atje, e patë vetë me sytë tuaja.

Znj. Hajnaj: Nuk ka rëndësi.

Znj. Çinari: Po ka rëndësi Anila!

Znj. Puka: Unë them të hiqet fare koncepti i performances.

Znj. Çinari: Jo jo, atë na i kërkojnë partnered.

Z. Aliaj: Kush e vlerëson performancën, dakort por kush e vlerëson?

Z. Hasanlami: Kryetari.

Z. Aliaj: Cili Kryetar?

Z. Arapi: Performancën e vlerëson MSG-ja.

Z. Aliaj: MSG-ja por jo Kryetari.

Z. Arapi: Ta mbaroj, e vlerëson MSG-ja dhe i propozon Kryetarit dhe thotë përfaqësuesi i shoqërisë civile X, referuar takimeve që kemi pasur kërkesave, kritikave dhe të gjitha këto, nuk

është fare aktiv, prandaj kërkojmë që ky përfaqësues ta hedhim në votë që ta largojmë këtë zotërinë, e largojmë, i bëjmë ftesë atij institucioni që të sjelli një tjetër por jo për ti thënë atij që largoje ti atë nga puna se ska ardhur në MSG. Se ai thotë nuk shkoj në MSG se ...

Znj. Puka: Po flet për veten e vet ai, se të gjithë do kenë performancë nuk ka vetëm shoqëria civile këtu, do ketë edhe biznesi.

Z. Arapi: Për të gjithë e thashë.

Znj. Puka: Çdo ..ka nevojë për një person që e inicion procesin, kush do ta bëj?

Z. Arapi: Kryetari i MSG-së.

Znj. Puka: Po ai thotë jo.

Z. Aliaj: Dritan Spahiu a kemi ne forcë për ta bërë sepse ky është i emëruar nga Ministri.

Z. Spahiu: Po nëse unë nuk marr pjesë në asnjë mbledhje...

Znj. Çinari: Po sigurisht që ke.

Z. Aliaj: Po si mund ta detyroj unë ministrin të vëj një tjetër?

Z. Arapi: Mbi baza indicie, Ilir nëse ka një indicie që Azbiu nuk vjen në mbledhje, nuk merr pjesë në diskutime dy, nuk nuk është aktiv.

Z. Aliaj: Po si mund ta detyroj unë ministrin?

Z. Arapi: Antari i shoqërisë civile kur të bëhet mbledhja e radhës së MSG-së, krahas gjithë këtyre ose me shkresë ti drejtohet Kryetarit të MSG-së edhe ti thotë i nderuar zoti Kryetar referuar çfarë ne kemi konstatuar 1,2,3,4,5 ju kërkojmë të shikoni nivelin e atij antari brënda në MSG dhe Kryetari merr faktet që i ke paraqitur ti dhe nëse faktet nuk janë bindëse, kërkesën tuaj e hedh poshtë, nëse janë bindëse e hedh në MSG që ky antar do ndërrohet dhe të zëvendësohet me një tjetër.

Z. Aliaj: Më fal Azbi, jemi në momentin ku i propozohet Kryetarit, faktet janë bindëse dhe po themi është Drejtorja e Tatimeve. Çfarë force ka që ti shkohet Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve ose Ministrin të Financave që duhet ta zëvendësosh këtë person?

Znj. Çinari: Po i thotë Zv/Ministrit pra, është kryetari i MSG-së.

Z. Aliaj: Po nuk mundesh.

Znj. Çinari: Po e kemi bërë Ilir, a e kemi dërguar?

Z. Aliaj: Ai thotë ai është përfaqësuesi im atje si do më detyrosh ti.

Znj. Puka: Në momentin që këto terma reference të hynë në fuqi, që kur bën nominimin i thua që personi që do nominosh do vlerësohet dhe ka këto pika të performancës, mbaron puna ja çon dhe institucionit dhe e zëvendëson.

Z. Aliaj: Një shtesë për këtë që thotë Azbiu, a mund të shkruhet këtu që të mund të ngrihet një grup pune me tre pjesëtar, një pjesëtarë nga biznesi, institucionet dhe shoqëria civile. Këto tre persona, kushdo të jenë do bëjnë një raport 6 mujor.

Z. Arapi: Për performancën e gjithësecilit.

Z. Aliaj: Erdhi nuk erdhi, foli nuk foli.

Znj. Hajnaj: Ne si shoqëri civile kemi në kodin tonë të sjelljes që do zgjidhet një përfaqësues që do japi mendimin e grupit të shumicës se grupit tonë. Atëhere si do ta përcaktoj kryetari i MSG-së që këtu flas unë dhe të vlerësoj Samiun në ka bërë performancë të mirë apo të keqe, kjo është pak e vështirë.

Z. Arapi: Është e vërtet ajo që thua ti, unë do i propozoj Kryetarit të MSG-së që antarët e shoqërisë civile, ne si MSG të shkojmë të bëjmë një takim me shoqërisë civile që ju përfaqësoni.

Znj. Puka: Po, është pika këtu, 40%, angazhimi në proceset reale.

Znj. Hajnaj: jo jo këtu në MSG si mund të përcaktohet që Maldlina ska qënë aktive. Ne si grup i shoqërisë civile e kemi për detyrë, ne, që të ketë një person këtu që të flasi në emrin tonë. Po nuk mund të thuhet performance e kryetarit duke qënë se do flas vetëm unë, 1, 2, 3 mbledhje sepse unë do them edhe mendimin e Samiut dhe duhet të mblidhemi.

Z. Shehu: Po përcaktohet ajo kur bëhet fjalë, thuhet shprehimisht po flas në emër të grupit.

Znj. Hajnaj: Po nuk ka performancë, performancën e përcaktojmë ne brënda grupit tonë.

Znj. Çinari: Si rregull Anila, thuhet po flas në emrin tim personal.

Z. Hasanlami: Faktikisht performanca nuk ka matje, nuk mund ta thuash megjithatë e shkruajmë por të modifikohet.

Z. Neza: Nuk më duket shumë normale ajo subjektive është. Unë mendoj të ngelet pjesa e mungesave në mbledhjen e MSG-së.

Znj. Çinari: MSG-ja ka një rol të caktuar, është e shkruar në Standart.

Z. Neza: Unë flas gjatë gjithë mbledhjes dhe Ilirit nuk i pëlqen ajo që flas unë.

Znj. Çinari: Nuk ka lidhje kjo!

Z. Neza: Po ka lidhje, nëse ska lidhje ska lidhje për asnjë për atë punë, do vendosim disa indikator të matshëm apo do vendosim disa indikator që prodhohen si shkak i perceptimeve të Ilirit për antarët e MSG-së. Subjektivizma.

Znj. Çinari: Atëhere më propozoni kush është një indikator performance.

Z. Neza: Unë indikator të performancës shoh që e ka shumë të vështirë një kryetar ta përcaktoj atë kur ai nuk ka kurrëfarë pushteti mbi ne dhe nuk ka kurrëfarë mundësie të na ndaj detyrat dhe të na bëj një feedback.

Znj. Çinari: Ok propozoni ju, ky është vetëm një propozim.

Z. Hasanlami: Sami si propozoni?

Z. Neza: Unë propozoj që performanca është subjektive dhe ai nuk mund ta masë. Në këtë rast i vetmi indikator performance që ai mund ta masë është pjesëmarrja. Në të gjitha rastet e tjera përcaktimi i tij është subjektiv dhe mund të bjerë ndesh me vetë interesat e MSG-së, rolin e MSG-së, misionin.

Znj. Çinari: Dakort çfarë sygjeroni ju?

Z. Neza: Unë them që kryetari nuk mund ta masë performancën e antarëve të MSG-së.

Znj. Çinari: Ne na kërkohet kjo shumë fort nga ata që na financojnë.

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Z. Hasanlami: E lame të modifikohet, të mos fillojmë bëjmë muhabet!

Z. Aliaj: A ka mundësi t`jua çoj me email?

Znj. Çinari: Çfarë?

Z. Aliaj: Ramë dakort ta modifikojmë.

Znj. Çinari: Si?

Z. Alikaj: Ta diskutojmë me email .

Z. Alikaj: Ka një zgjidhje përshëmbull të mos zgjidhet më.

Znj. Çinari: Si ka një?

Z. Alikaj: Të mos zgjidhet më ky person që është ...kur të vij puna vetë shoqëria civile të thotë mos e zgjedhim Përparim Alikaj sepse kështu kështu, po e zgjodhi iku ai muhabet ska më.

Znj. Çinari: Do humbisni tre vjet këtu me personat që sbëjnë punë? Si të doni

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Z. Shehu: Në institucionet shtetërore çdo vit bëhen performancat e secilit.

Z. Neza: Dorina ne vijmë nëpërmjet një procesi zgjedhor këtu, anëtarët e shoqërisë civile vijnë nëpërmjet zgjedhjeve dhe nga ky moment që zgjedh antarët e shoqërisë civile në MSG ja vendos një vlerësim të dytë nga kryetari i MSG-së.

Znj. Çinari: Pse shoqëria civile nuk ka nevojë të dijë nëse këto njerëz që ka zgjedhur po performojnë apo jo?

Z. Neza: Proçesi i zgjedhjes është i lidhur me kapacitetin e tyre Dorina.

Z. Aliaj: Nuk mund ta bëjë vlerësimin kryetari i MSG –së.

Znj. Hajnaj: Po.

Znj. Çinari: Po ja ku e ke personin që stë vjen një vit e gjysëm, çfarë mase keni marrë?

Z. Neza: Ju propozoni këtu tre momente të matjes së performancës.

Znj. Çinari: Po tre indikatorë.

Z. Neza: Atëhere ne do gjykojmë këtë pikë, i pari është ok, jam plotësisht dakort. Të dy të tjerat po them që janë shumë subjektive në shumë pika, ne po i shohim nëse secila prej këtyre pikave mund ti mbajmë dhe mund ti gjykojmë dhe mund të pranojmë gjykimin e Kryetarit të MSG-së sepse mua më duket kjo një moment me shumë përgjegjësi. Nëse ne ja japim të drejtën Kryetarit të MSG-së për të gjykuar mbi antarët e MSG-së përfshirë edhe shoqërinë civile do të thotë që ne i kemi dhënë të drejtën atij, një të drejtë që është në kundërshtim me standartet EITI vetë.

Znj. Çinari: MSG-ja nuk është vetëm shoqëria civile.

Z. Neza: Ne jemi të barabartë në MSG, shoqëri civile, biznesi, qeveri janë të barabartë në MSG. Në momentin kur ne ja japim Kryetarit të MSG këtë gjë e kemi prishur këtë ekuilibër.

Znj. Çinari: Po për çfarë është kryetari i MSG-së?

Z. Neza: Kryetari i MSG është përfaqësues i qeverisë në MSG.

Znj. Çinari: Cili është roli?

Z. Neza: Roli i tij është të drejtoj mbledhjen, të bëj axhendën, të koordinoj MSG-në me EITI-n

Znj. Çinari: Kryetari MSG koordinon MSG-në me EITI-n.

Z. Neza: Po.

Z. Alikaj: Dorina njëherë në vit ne mund të bëjmë një anketim të gjithë votojmë për njëritjetrin.

Znj. Hajnaj: Jo jo.

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Z. Neza: Të kthehemi dhe të përcaktojmë qartë këto tre gjëra. I pari është ok, dy të tjerat nuk janë ok.

Znj. Hajnaj: Performanca është shumë e kollajshme të përcaktohet.

Z. Neza: Dorina çënohet një standart.

Z. Aliaj: A ka mundësi ta çojmë me email?

Znj. Hajnaj: Performanca është shumë e kollajshme nga kryetari i MSG-së për tu matur. Nëse Banka Botërore ja kërkon dhe e kanë detyrim...

Z. Shehu: Nuk është punë Banka Botërore këtu.

Znj. Hajnaj: Vetëm banka botërore e kërkon atë.

Z. Aliaj: Po kush është BB se nuk është BB vetëm ajo zonja?

Znj. Çinari: Është emaili nuk është zonja.

Znj. Hajnaj: Ilir më fal ai mund të shohi këtë gjë. Në të gjitha mbledhjet e MSG-së ka qënë aktive shoqëria civile dhe çfarë propozimesh ka bërë dje janë të gjitha në Minutes of Meetings.

Znj. Çinari: Anila po nuk matet në mbledhje MSG-je performanca, shoqëria civile ka fokus tjetër.

Znj. Hajnaj: Çfarë detyre kemi ne aprovimin e fondeve të Bankës Botërore?

Znj. Çinari: Anila e ke lexuar ndonjëherë standartin, se po më çudit?

Znj. Hajnaj: Kjo është vetëm te fondet e Bankës Botërore që kërkon performancën.

Znj. Çinari: Anila, kush është roli?

Z. Aliaj: Edhe kush është BB, pse duhet të ndjekim ne atë që thotë BB, çfarë detyrimi ligjor kam unë që duhet të ndjek BB, jo Bankën Botërore por zonjën Ilhem Salamon(*Flasin disa veta në të njëjtën kohë*)

Z. Shehu: Anila të lutem cili është koncepti juaj për performancën se këtu po diskutojmë mandatin..

Znj. Hajnaj: Më fal të lutem çfarë detyre kemi ne këtu?

Z. Shehu: Mandati që të jepet e ka të detyruar se çfarë problemesh do ndjekësh, ama performanc tregon nivelin e punës që bëhet çdo vit.

Znj. Hajnaj: Po pra dhe çfarë pjesëmarrje kam unë.

Z. Shehu: Performancë e vlerësuar nuk do të thotë që duhet të të hiqet mandati apo duhet të zëvendësuar personi por tregon performancën e nivelit të punës që bëhet.

Znj. Çinari: Validon.

Znj. Hajnaj: Po pra, çfarë detyre kam unë këtu?

Z. Shehu: Pra këta tregues tregojnë sa herë ke ardhur, çfarë pune ke bërë, çfarë website-i i ke pasqyruar dhe jo vetëm të një individi por edhe shoqëria juaj në tërësi, juaja e Ilirit...

Znj. Hajnaj: Më fal të lutem por çfarë detyre kam unë këtu si anëtare?

Z. Shehu: Në këtë pozicion performanca tregon puna që bëhet për secilin, jo për shoqërinë civile.

Znj. Hajnaj: Puna që bëhet për MSG-në të lutem, ne jemi këtu për MSG-në, se çfarë bëj unë jashtë MSG-së...

Znj. Çinari: Jo jo e ke gabim, është e kundërta.

Z. Shehu: E ke gabim, ne po flasim për EITI-n.

Znj. Hajnaj: Unë e kam në Kodin tim.

Znj. Çinari: Po ku e ke kodin?

Znj. Hajnaj: Nesër e ke në tavolinë.

Znj. Çinari: Po sille pra se ke kohë që thua do sjell Kodin.

Z. Neza: Çoja atë Kodin se ka të drejtë këtu.

Znj. Hajnaj: Ke të drejtë unë e kam fajin për Kodin që nuk ta kam sjellë dhe te Kodi atje janë detyrat e mia që kam dhe performanca ime është për këtë detyrë që kam unë këtu. Performanca

Znj. Hajnaj: Shumë bukur, do ta thotë këtë gjë por ti nuk mund ta përcaktosh individuale performancën se kush ka dhënë mendimin pro dhe kundër.

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Z. Shehu: Performanca është një rezultat ...rezultati cili është?

Znj. Hajnaj: Rezultati është që ne jemi më aktivët nga të gjithë këtu.

Znj. Çinari: Çfarë bëni në terren ai është roli juaj.

Z. Hasanlami:Ju lutem vendosim një farë rregulli dhe të diskutojmë me rradhë.

Znj. Çinari: Ka një paqartësi të madhe koncepti.

Z. Hasanlami:Unë jua thashë edhe në fillim ...e performances të një shoqërie civile që përfaqëson një apo me përfaqësuesin e këtij këtu. Pra këtu do të gjejmë një moment dhe thamë ta modifikojmë këtë problemin e performancës sepse nëse një shoqëri civile dërgon Ilirin si përfaqësues, automatikisht është edhe ajo e shkatërruar si shoqëri ose ai Iliri që vjen këtu vjen tamam me gjithë atributet e një shoqërie me performance të mirë, nëse Iliri vjen këtu dhe nuk sillet mire automatikisht si individ dhe merr atë shoqërinë civile atje dhe i thua nuk do më dërgosh Ilirin por Mehmetin apo një tjetër kë zgjedhin ata, se ti tani do zëvendësosh Ilirin apo shoqërinë që përfaqëson Iliri.

Znj. Puka: Po ne jemi nominative, kështu na kanë cilësuar.

Z. Hasanlami:Jo jo e kam këtu, a do ta heqim komplet si përfaqësues dhe të marrim një përfaqësues të një shoqërie tjetër apo?

Znj. Çinari: E zgjedhin vetë këta.

Z. Hasanlami:Jo mund ta heqësh dhe fare si shoqëri sepse përshëmbull Anila me këtë performancë që bën në shoqëri nuk vlen edhe e heq edhe si...

Z. Aliaj: Në fillim të debatit për këtë draft, ne e lamë që do diskutojmë dhe në pikat që nuk biem dakort do i shtyjme dhe do e sjellim mendimin tonë me email. Nuk po merremi vesh në

këtë pikë, a ka mundësi tjua dërgojmë me email dhe nëse është e nevojshme ta diskutojmë edhe me email.

Z. Arapi: Ti e thua këtë se nuk ke pasur kohën e duhur apo nuk vjen shprehja për ta thënë direkt këtu?

Z. Aliaj: Jo unë e kam thënë mendimin tim.

Znj. Çinari: Cili është propozimi juaj Ilir?

Z. Hasanlami:Keni ndonjë ide më të qartë?

Z. Aliaj: Unë jam që të hiqet fjala performancë.

Z. Hasanlami:Performancë nuk hiqet, nëse e modifikojmë më mbrapa performancës.

Z. Aliaj: S'po bien dakort pra.

Z. Hasanlami:Po thuaje ti.

Z. Aliaj: As unë për momentin nuk kam ndonjë mendim të ndryshëm

Z. Hasanlami:Ke Sami ti ndonjë mendim?

Z. Aliaj: Nuk po biem dakort, ta shtyjmë, ta diskutojmë.

Z. Hasanlami:Se ke ti por mund ta ketë Anila një mendim më të mirë.

Z. Arapi: Unë jam për performancën, se nuk mund të jesh pjesë e kësaj tavoline dhe ta them troç, kur nuk ja var asnjëherë kësaj tavoline.

Z. Aliaj: Kthehemi prapë te pjesa e diskutimit, kush do e bëjë diskutimin kush do e bëjë vlerësimin?

Znj. Çinari: Cfarë propozoni?

Z. Hasanlami:Ne e mbyllëm, e kalojmë këtë pikë deri në fund të mbledhjes.

Z. Aliaj: Ose me vonë, brënda javës.

Z. Hasanlami: Tentoni për të bërë ndonjë përpilim tani se e mira është të kalojë kjo.

Z. Neza: Dorina tek ai dokumenti që ti se ke marrë ende, tek Kodi i Etikës, janë të përcaktuara qartë momentet kur përfaqësues të shoqërisë civile në MSG largohen nga MSG-ja për arsye të specifikuara.

Znj. Çinari: Po kompanitë?

Z. Neza: Për kompanitë nuk e di dhe kjo është futur në Kodin e Etikës dhe Kodi i Etikës e vet rregullon këtë proces për ne.

Znj. Çinari: Ai është dokument i juaj i brendshëm, ne po flasim për një dokument që rregullon gjithë MSG-në.

Z. Neza: Unë mendoj ta marrim atë pjesën tek Kodi Etikës që kemi ne për veten tone dhe për rastin e antarëve të shoqërisë civile në MSG, të implementohet ajo pjesë e Kodit të Etikës.

Z. Hasanlami: Tentoni ta modifikoni tani pa hequr performancën, vazhdojmë.

Z. Arapi: Kisha dhe një pyetje, se ndoshta se kam fiksuar mire. Sa mandate mund të zgjidhen këto?

Znj. Puka: Dy herë.

Z. Neza: Eshtë e përcaktuar.

Znj. Çinari: Të gjithë.

Znj. Puka: Jo ne e kemi te Kodi jonë 6 vjet.

Z. Arapi: OJF ju e keni vetë në Kod.

Znj. Hajnaj: Tre vjet, por pastaj mund të përsëritet nëse brënda nesh vendosim të bëjmë zgjedhje.

Z. Arapi: Nuk e di a është përcaktuar nëse këto bëjnë dy mandate nuk kanë të drejtë, pavarësisht se ngul këmbë shoqëria civile atje që thotë jo sepse, sipas mendimit tim për arsye se unë kam marrë pjesë në takime edhe me Përparimin edhe me Samiun edhe di që këto

përfaqësues të shoqërisë civile që kanë ardhur dhe janë pjesë aktuale e MSG kanë bërë ca trajnime të cilat për mua janë vlera për shoqërinë Shqiptare edhe për këtë tavolinë.

Z. Hasanlami:Do ta bësh tre here ti?

Znj. Çinari: Po ky nuk i heq trajnimin shoqërisë civile, fakti që nuk je në MSG nuk ja heq trajnimin.

Z. Arapi: Ta mbaroj ky është mendimi im, si do të parashikohet këtu, nuk kanë më të drejtë të zgjidhen këta përfaqësues pavarësisht trajnimeve të mjaftueshme që kanë marrë.

Znj. Puka: Këta mund të jenë trajnerë të atyre që do vinë këtu dhe është më fitimprurëse, të jesh 6 vite vullnetar dhe 6 vite kështu, vetëm të bëhesh budalla, më mirë bëhu trajner me pagesë sesa antar në MSG prej kaq vitesh.

Znj. Hajnaj: Ne e kemi në Kodin e sjelljes që antarët e vjetër të cilët janë aset të shoqërisë civile.

Z. Aliaj: Po thotë tjetër gjë Azbiu .

Z. Hasanlami:Azbiu thotë të mos jenë dy por tre mandate.

Z. Arapi: Është e përcaktuar që do ta lëmë dy.

Po (përgjigjen shumica)

Z. Arapi: Ok pikë, mbaroi

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Znj. Puka: Tani unë kam një propozim, personalisht mendoj që performanca duhet se në bazë të MSG-së diskutohet se si ecen gjithë pjesa e Shqipërisë në EITI. Ne jemi personat, për mua performanca, vlerësimi i MSG-së është shumë i rëndësishëm. Çështja se si do bëhet duhet ta diskutojmë. E dyta një proces performace në çfarë do lloj elementesh ka gjithmonë një person apo një institucion që e inicion. Në rastin tuaj, thuhet që Kryetari bordit bën validimin ne mund të gjejmë një formë më të regullt që është përgjegjës për validimin dhe pastaj të bashkohet qoftë në mënyrë të pavarur por duhet kemi pastaj të sakta kriteret e performances dhe kthehem prapë te % tuaja, 30-30-40. Përshëmbull pjesa e parë pjesmarrja në takime 30% është një fjalë shumë e

hapur, në çfarë lloj takimesh të MSG-së, në konferenca apo çfarë ndodh gjatë vitit, se ka mundësi ne mund të vimë por ka mundësi që nuk na krijohet asnjëherë mundësia për të ardhur. Të sqarohet qartësisht.

Z. Hasanlami:Në MSG.

Znj. Çinari: Të mbledhjeve të MSG-së.

Znj. Puka: Po jo vetëm të MSG-së por ka një serë eventesh që mund të...

Znj. Hajnaj: Kjo është pjesë e MSG-së.

Znj. Puka: Të shënohet për çdo gjë sepse ju ofroni vazhdimisht evente.

Znj. Hajnaj: Kjo është rregullore e MSG-së.

Z. Aliaj: Medlin kjo është rregullore e MSG-së, e ka në titull.

Znj. Puka: Kush është rregullore?

Z. Aliaj: Kjo pra që po diskutojmë.

Znj. Puka: Unë po flas te pika 30 %, pjesëmarrje në takime, duhet sqaruar.

Z. Hasanlami: E shtojmë aty të MSG-ja.

Znj. Puka: Po flas për kriteret e performances.

Znj. Çinari: Dhe evenimente të tjera mbështetëse.

Znj. Puka: Niveli i performancës apo kriteret e performances duhet të jetë i përcaktuar më saktë se sa 30-30-40. Po të hysh brënda ka shumë subjektivizëm, angazhimi në proceset konsensus në ndërtimin e politikave, komentet domethënëse, pak a shumë merret, ne po marrim pjesë dhe po bëjmë komentin.

Znj. Çinari: Po.

Znj. Puka: I bie sikur merr 2 pikë, edhe merr pjesë edhe bën komente. Mund ta sqarojmë mos të jetë kaq subjektive pjesa e 30%.

Znj. Çinari: Çfarë propozon?

Z. Aliaj: E ke gabim se mund të marrësh pjesë dhe ja fut gjumit.

Znj. Puka: Nuk besoj që mbledhjet e MSG-së janë të tilla sa ne të na jepet mundësia për të fjetur gjumë.

(Flasin disa persona në të njëjtën kohë)

Znj. Puka: Po pra unë po flas vetë dhe më lini kohën time se unë deri tani po ju dëgjoja. E njëjta gjë, emaile, korespondenca duket pak a shumë janë disa element që nuk kërkojnë ndonjë gjë, janë shumë subjektive. 40%, ti mund të mos komentosh fare si përshëmbull unë nuk kisha komente tek kjo e para dhe nuk do të thotë që unë nuk jam aktive, e kam lexuar, rashë dakort me këtë, ishin me standartet e zakonshme.

Z. Aliaj: Po thuaj ti jam dakort, kaq

Znj. Çinari: Ne jemi mbledhur për Termat e Referencës dhe MSG-ja ka detyrimin ta aprovoj.

Znj. Puka: 40% tjetër.

Znj. Çinari: Është detyrim.

Znj. Puka: Jo se po dalim tani kush shkruan më shumë 10 faqe, mund të jetë më aktivi, ndërkohë ndonjë që e lexon ..ndërkohë 40 % angazhimet në proceset reale EITI, pak a shumë kjo është për të tërë por meqënëse shkruhet, duhet të kemi ndonjë pikë tjetër që vetë shoqëria civile, biznesi apo dhe juve të na jepet mundësia që ta bëjmë këtë gjë në terren sepse jo të gjithë vimë nga...

Znj. Çinari: Atëhere formulimi i shoqërisë civile në MSG, të ketë kapacitetin për të kryer veprimtari intensive outreach dhe komunikimi, ky është sipas standartit.

Znj. Puka: Ok të shënohet në një pikë tjetër edhe kjo.

Znj. Çinari: Kjo është veprimtaria e pavarur e MSG-së?

Znj. Puka: Normalisht pra po do vijë momenti, po mirë si do ta masësh biznesin ti në angazhimet në proceset reale të EITI?

Znj. Çinari: Çfarë kalendari keni bërë gjatë vitit në kuadër të EITI?

Znj. Puka: Biznesi? Tatim taksat, të gjitha.

Znj. Çinari: Po, po si kontribuojnë ata në process.

Znj. Puka: Po flas të hapen, e keni shumë mirë të ndarë, pesha 30-30-40, por brënda duhet të ketë tike me radhë, ku do ecin gjithë këto gjëra është jashtë mase madje nëse ne do të arrijmë të bëjmë dhe performancën të ketë një aneks.

Znj. Çinari: Jam shumë dakort, na ndihmon nëse na ndihmoni ta detajojmë.

Znj. Puka: Unë kaq kisha.

Znj. Çinari: Shumë dakort, si ta detajojmë?

Z. Aliaj: E lamë që do e sjellim.

Znj. Çinari: Kush do ta sjelli komentin me shkrim nga kush do ta presim?

Znj. Puka: Nga të gjithë edhe biznesi besoj.

Z. Hasanlami:Merre përsipër tani.

Znj. Puka: Grupi jonë do ketë pjesën e vetë.

Z. Aliaj: Anila do e sjelli.

Z. Hasanlami:Kalojmë tek funksionet e përbashkëta.

Znj. Çinari: Ecim.

Z. Aliaj: Pika 15 e imja, 11 e draftit.

Z. Hasanlami:Vendimmarrja.

Z. Aliaj: Vendimmarrja.

Z. Hasanlami:Po.

Z. Aliaj: Unë them përpara se të kalohet tek votimi duhet të kemi vendosur numrin minimal të pjesëmarrësve.

Z. Neza ...

Z. Aliaj: Po mire duhet ta vendosin.

Z. Neza: Dorina a është e vendosur?

Znj. Çinari: Kam përshtypjen që është e shkruar.

Z. Aliaj: Po ta shkruajmë diku.

Znj. Çinari: E kemi shkruar, 50% e antarëve.

Z. Aliaj: Unë s'e kam gjetur.

Znj. Çinari: E ke këtu Ilir, vendimarrja në MSG do të synoj të arrihet në çdo rast me konsensus. 50% e antarëve me të paktën një përfaqësues nga qeveria, shoqëria civile dhe sektori i biznesit do të përfaqësojnë kuorumin e grupit ndërinstitucional. Ecim!

Z. Hasanlami: Si e lame këtë?

Z. Aliaj: Qënka e qartë

Z. Hasanlami: Dakort! Numri 16 i Pikës 13, konflikti i interesit. Duke qënë që Sekretariati vendos për planin e punës, vendos për projektin (lexon nën zë), ku qëndron problemi këtu?

Z. Aliaj: Unë nuk jam dakort me këtë pikë.

Z. Hasanlami: Cfarë të keqe ka këtu Ilir?

Znj. Çinari: Kjo është një nga elementet më të rëndësishme që forcohet çdo bord EITI dhe çdo..

Z. Hasanlami: Çfarë problemi ka këtu tani?

Z. Aliaj: Këtu thuhet, vendos për projektet, vendos për planin e punës, vendos për projektet që do zbatohen, strategjinë që duhet ndjekur dhe vlerëson zbatimin e tij. Kjo është pak a shumë, apo jo?

Z. Hasanlami: Po.

Z. Aliaj: Atëhere unë nuk shoh ndonjë konflikt interesi këtu mes antarëve të MSG-së dhe pjesës që shqyrtohet në këto pika.

Znj. Çinari: Nëse propozon për një projekt dhe pastaj tenderoni për të njëjtin projekt, atëhere ju i jepni vetes një avantazh kompetitiv ndaj të tjerëve.

Z. Aliaj: Pse?

Znj. Çinari: Sepse këto janë principet kryesore të konfliktit të interes.

Z. Aliaj: Kjo ndodh në të gjitha MSG-të e tjera.

Znj. Çinari: Kush janë MSG-të e tjera?

Z. Aliaj: Azerbajxhani.

Z. Hasanlami: Çfarë thotë ai Azerbajxhani?

Z. Aliaj: Që nuk ka konflikt interesi të tillë.

Znj. Çinari: Po shko puno me MSG-në e Azerbajxhanit.

Z. Aliaj: Jo nuk kam nevojë, shko ti puno atje.

Z. Hasanlami: Ilir është i vetmi rast që unë mendoj që ti nuk ke absolutisht të drejtë sepse nëse unë jam përfaqësues edhe kërkoj projekte, unë them që kjo të rri ashtu siç është se është shumë bukur.

Z. Aliaj: A mund të kem mendimin tim?

Znj. Çinari: Termat e Referencës të Administratorit të Pavarur vetë EITI i ka shënuar që te blloku i vetë termat e Administratorit të Pavarur.

Z. Aliaj: Po unë nuk jam Administrator i Pavarur.

Znj. Çinari: Ju votoni për Termat e Referencës të Administratorit të Pavarur, pra thotë MSG-ja duhet të jetë e çliruar nga çdo lloj konflikti interesi kur vendos për Administratorin e Pavarur.

Z. Aliaj: S'kam asgjë të keqe këtu.

Z. Hasanlami: Unë mendoj ta kalojmë këtë.

Znj. Hajnaj: ...po jemi dakort se ishin edhe ato të Bankës Botërore

Z. Aliaj: Je ti dakort unë jo.

Znj. Hajnaj: Po e morëm vesh si është procesi ato kanë kërkesat e tyre.

Z. Neza: Pse duhet të futet në ToR kjo pjesa?

Z. Hasanlami: Është histori e mbyllur, vazhdojmë në pikën tjetër. Dorina unë mendoj se kjo është e panegociueshme.

Znj. Çinari: Kjo kështu duhet të jetë e formuluar!

Z. Hasanlami: Pikërisht.

Znj. Çinari: Se si e gjejmë ajo është tjetër gjë..ti a shkon takon donatorin edhe i thua kam këto projekte dhe ai nuk është tenderim, kupton?

Z. Neza: Po pse futet kjo?

Znj. Çinari: Sepse na kërkohet.

Z. Hasanlami: Nuk mundet të konkurosh ti tani për një projekt të EITI-t.

Z. Shehu: Më fal një pyetje, në rast se thuhet antari i MSG-së, antari përfaqëson edhe shoqatën dhe shoqata ..

(Flasin disa persona në të njëjtën kohë)

Znj. Puka: Ashtu i bie të ishte gjithë Shqipëria këtu antarë.

Z. Shehu: Antari i MSG-së është antar i MSG-së, shoqata ka edhe antarë të tjerë..

Z. Aliaj: Votoj kundra.

Z. Hasanlami: Nëse e zëmë Mehmeti përfaqëson ..edhe njëherë ta konceptojmë në organizatë direkt në mënyrë absolute është krejt i drejtë formulimi dhe mbyllet historia, nëse është grupim organizatash një pjesë tjetër ..

Z. Shehu: Po pra grupime janë këta, faktikisht kanë një sektor të grupuar, një sektor tjetër mund të aplikojë.

Znj. Çinari: Mund të ndikojë negativisht.

Z. Hasanlami: Ke shumë të drejtë.

Znj. Çinari: Do shkruhet kështu dhe pikë Anila, nuk ka ku rri po të shkruhet ndryshe.

Znj. Hajnaj: Po konflikti i interesit është vetëm për fondin e Bankës Botërore.

Znj. Çinari: Po jo Anila, ne si qeveria Shqiptare në momentin që do ta tenderosh do të kërkoj një formular për konflikt interesi, qeveria shqiptare.

Z. Hasanlami:Po pse e zgjasni kot?

Znj. Çinari: Se nuk e kuptojnë.

Z. Hasanlami:Dorina, kjo është e pa negociueshme mos e zgjasim kot. Vazhdojmë pika 14.

Z. Neza: Jam kundër me mënyrën se si është shprehur.

Znj. Çinari: Te cila?

Z. Neza: Tek pika 16, te konflikti i interesit. Të detyrohet koncepti i konfliktit të interesit absolutisht, por të mos jetë përjashtues, të mos përjashtojë mundësinë e kooperimit.

Znj. Çinari: Sami, këtë nuk po e shpikim ne, por është instruksion i EITI-t Ndërkombëtar.

Z. Neza: Nuk është se kemi pasur raste ose ndeshje në lidhje me këtë histori. Iliri thotë se ka praktika në vende të tjera

Z. Aliaj: Ke pra në Azerbajxhan.

Znj. Çinari: Azerbajxhanit i është hequr statusi.

Z. Aliaj: I është hequr statusi jo për këtë çështje, i është hequr statusi sepse kanë dhunuar shoqërinë civile.

Znj. Çinari: E kanë futur në burg, i kanë mbyllur llogarinë bankare.

Z. Aliaj: Po nuk është për konflikt interesi.

Znj. Çinari: Po mund të dali, ju i dini diskutimet apo nuk i dini diskutimet që janë bërë në bord për konfliktet e interesit të shfaqura gjatë proceseve?

Z. Hasanlami:Unë jam dakort që të bëhet, kur je përfaqësues i një grupimi të madh organizatash, mund ta marrësh e zëmë por nëse ti je personalisht përfaqësues i një shoqate absolutisht si shoqëri civile nuk mund të marrësh projekte këtu dhe kjo është taksative dhe nuk besoj të negociohet.

Z. Neza: Duke u nisur nga një koment i Agimit, si mund të veçohet antari nga organizata në këtë rast?

Z. Hasanlami:Unë e kam këtu, përshëmbull Ilir përfaqëson shoqërinë civile nr. 2, 10 shoqëri civile kanë zgjedhur Ilirin si përfaqësues këtu. Iliri për shoqërinë nr.2 duhet të rrijë shumë larg projektit që përcakton EITI dhe MSG-ja. Nëse është e Samiut apo e Azbiut brenda këtij grupi që e kanë zgjedhur edhe mundet, këtë them unë me atë llogjikën time.

Znj. Hajnaj: Po mirë ne kemi një koalicion me disa shoqëri civile aty brenda.

Z. Hasanlami:Konkretisht ti si koalicion a je përfaqësuese e njërës?

Znj. Hajnaj: Po. Katër prej nesh janë përfaqësues të secilës organizatë, pesë të tjera.

Z. Hasanlami:Nuk mund të marrësh projekt.

Znj. Hajnaj: Ato të tjerat?

Z. Hasanlami:Të tjerat po pra thashë unë.

Znj. Hajnaj: Ok, se nuk po flas për ne.

Z. Neza: Nëse kjo është përjashtim vetëm për Azerbajxhanin, unë mendoj nga praktikat që kam parë unë dhe kontaktet që kemi me shoqërinë civile e vëndeve të tjera, ato financohen kryesisht nga dy donatorë nga BB dhe Sorosi.

Znj. Çinari: Po financohen! Po financohen drejtpërdrejtë, jo nëpërmjet fondit që merr qeveria Shqiptare.

Z. Neza: Ju keni bërë takim, Ilir ju keni që në takim me BB, unë nuk kam qënë.

Znj. Hajnaj: Banka e tha në mënyrë kategorike, nuk po diskutojmë këtë.

Znj. Puka: Banka e tha në mënyrë kategorike.

Z. Aliaj: Po vetë banka e jep në Azerbajxhan të njëjtën gjë, apo nuk prish punë?

Znj. Çinari: Qeveria e Azerbajxhanit i merr fondet?

Z. Aliaj: Ky fondi i Grantit që vjen si në AlbEITI-n tonë.

Znj. Çinari: Nëse ne bëjmë një require te BB dhe themi që MSG e Azerbajxhanit financon projekte për antarë të MSG-së, mendon që do ketë problem për ata se mund ta bëjmë një require dhe do dali që ka një problem pastaj në MSG-në e Azerbajxhanit?

Z. Aliaj: Për kë do ketë problem, për ato të Azerbajxhanit. Po çlidhje kam unë se i del problem atyre?

Znj. Çinari: Po se po na i sillni si shëmbull.

Z. Aliaj: Po unë e sjell si shëmbull që banka e di këtë.

Znj. Çinari: Jo nuk e dinë.

Z. Aliaj: Kush tha që nuk e dinë?

Znj. Çinari: Do bëjmë pyetje.

Z. Spahiu: Azerbajxhani nuk është rasti më i mirë, se aty nuk është sukses.

Z. Aliaj: Dritan aty nuk është sukses se futi në burg shoqërinë civile.

Z. Spahiu: Jo në përgjithësi them si organizim.

Z. Aliaj: Ata janë që na kanë mbajtur këtu se ne ishim duke u përjashtuar, ata të Azerbajxhanit janë. Kur erdhi Drejtuesja e re e AlBEITI-t, mos ishte Azerbajxhani ne na hiqnin.

(Flasin disa persona në të njëjtën kohë)

Znj. Hajnaj: Unë të thashë për këtë, ok në rregull.

Znj. Çinari: Ti duhet të jesh në rregull me një validim që të vjen dhe të thotë e kam të parashikuar këtë klauzolë që thotë kështu dhe ty ta rrit vlerën si MSG sepse i ke parashikuar gjithë elementet.

Z. Neza: Atëhere çfarë do bëjmë?

Znj. Puka: E mbyllim.

Z. Aliaj: Por kemi dhe një pikë, unë sjam dakort.

Z. Neza: E lëmë atë.

Znj. Puka: Jo po duhet sqaruar, një sekondë. BB për momentin i jep shumë fuqi MSG-së në validimin në programin e saj, grantit dhe normalisht kur ti hyn në programe të tilla ti nëse je valuter me BB nuk mund të jesh edhe zbatues qoftë edhe i një komponenti të vogël të saj. Kur bëhet fjalë për grant, për palët. Unë e kam në shtëpi na e dhanë atë ditë dhe e kam lexuar dhe kjo është bërë copy-paste e asaj.

Z. Neza: Nëse do ndryshojmë raportet tona me BB mund ta bëjmë ndryshimin në rregullore më pas pastaj.

Znj. Puka: Jo ata thanë që ka dritare të tjera.

Znj. Çinari: Konflikti i interesit, të jesh i sigurt Sami, që do jetë gjithmonë. Është e zeza mbi të bardhë.

Z. Neza: Nuk po flas për këtë. Konflikti i interesit si koncept është shumë i rëndësishëm për të qënë në ToR dhe jam plotësisht dakort. Ne po bisedojmë tani për një moment konkret i cili po na paraqitet me dy pamje. Një pamje e jona që nuk ashtu dhe një pamje tjetër.

Znj. Çinari: Do pyes për Azerbajxhanin.

Z. Shehu: Sami një ndërhyrje.

Z. Neza: Po.

Z. Shehu: Në rast se bën propozim për..universitetin që është i lidhur me shkencat e komunikimit, i specializuar në këtë fushë dhe ti punon atje, je në konflikt interesi ti që bën propozimin për këtë pozicion?

Z. Neza: Po.

Z. Shehu: Atëhere kjo duhet sqaruar. Se thuhet antarët e MSG-së nuk thuhet antarët që përfaqësojnë shoqatën.

(Flasin disa persona në të njëjtën kohë)

Z. Alikaj: Më falni edhe një pyetje, që unë nuk shoh këtu lidhur me transparencën për fondet EITI-t. Ka ndonjë pikë këtu se unë nuk e pashë?

Z. Neza: Jo nuk ka.

Znj. Çinari: Jo nuk ka por kush është pyetja juaj konkretisht?

Z. Alikaj: Si do të bëhen këto se vinë ka shumë drejtime.

Znj. Çinari: Ju keni nevojë të keni transparencë?

Z. Alikaj: Po të gjitha.

Znj. Çinari: Sepse fondet e EITI-t monitorohen.

Z. Alikaj: Se vinë nga shumë drejtime.

Znj. Çinari: Monitorohen nga Banka Botërore.

Z. Alikaj: Si do dalin këto, si do shprehen?

Znj. Çinari: Atëhere ne kemi dy burime financimi, një është buxheti shtetit, i cili paguan vetëm pagat dhe dy është Granti i BB, këto janë burimet tona të financimit.

Z. Alikaj: Bukur.

Znj. Çinari: Kemi pasur një fond nga donatorët e tjerë që e kemi shpërndarë në dy projekte për shoqërinë civile. Ai ka mbaruar kjo ka qënë e gjitha.

Z. Alikaj: Çfarë do shprehet këtu, pavarësisht, si do shprehet këtu.

Znj. Çinari: Atëhere buxheti i shtetit kontrollohet nga Auditi i Ministrisë së Energjisë, nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, nga ILDKP. Buxheti i BB kontrollohet nga Auditi i Ministrisë së Energjisë nga KLSH, nga Auditi i BB, nga Big Four..

Z. Hasanlami:Tani profesori ka një të drejtë.

Znj. Çinari: Ju dëshironi të keni çfarë, raportet e auditimit?

Z. Alikaj: Një pikë, këto që the ti.

Znj. Puka: Jo,jo! Është pika pra, ne si MSG vlerësojmë zbatimin e planit të punës EITI, tek pjesa e zbatimit mund të shënoni financat.

Z. Aliaj: Ideja e profesorit është që ka një prokurim, siç ndodh.

Znj. Çinari: Roli i MSG-së nuk është prokurimi Ilir, është Zbatimi i Strategjive dhe Politikave. Prokurimet i monitoron BB, i monitoron KLSH.

Z. Aliaj: Atëhere pse bëhet EITI, se edhe biznesin në Shqipëri e kontrollon Ministria, AKBN-ja, Taksat etj.?

Znj. Çinari: Çfarë sygjeroni konkretisht Ilir. Po del nga kuadri i MSG.

Z. Aliaj: Vazhdoni flisni ju, se unë nuk po flas.

Znj. Çinari: Ti ke një fokus tëndin.

Z. Aliaj: Sigurisht që kam një fokus.

Znj. Çinari: Fokusi yt janë tenderimet, fokusi i MSG-së ...

Z. Aliaj: Ti nuk e ke idenë se çfarë është fokusi im, nëse doni ta ktheni personale, unë po flas normalisht.

(Flasin disa persona në të njëjtën kohë)

Z. Alikaj: Te kjo që them unë a ka ndonjë gjë që duhet shtuar?

Znj. Çinari: Çfarë dëshironi të keni konkretisht?

Z. Hasanlami: Profesor keni ndonjë mendim direkt, e shtojmë ne?

Znj. Hajnaj: Në mbarimin e çdo projekti të sillet një raport i plotë financiar dhe narrativ i projektit të mbuluar, t'i raportohet MSG-së.

Z. Hasanlami: Ta shkruajmë këtë, ku doni ta shkruani?

Z. Alikaj: Se do ketë donacione, do ketë nga BB, të dali një gjë e tillë

(Flasin disa persona në të njëjtën kohë)

Znj. Çinari: Sepse ne sjellim kalendarin e aktiviteteve këtu që e keni të update-uar.

Z. Alikaj: Unë e them si rregullore, jo konkretisht por si rregullore.

Znj. Çinari: Formulojeni ju lutem çfarë dëshironi të shtoni.

Znj. Puka: Unë propozoj konkretisht këto gjërat që janë te pjesa e konfliktit të interesit ku thuhet në mënyrë eksplicite se çfarë do bëjmë, që ne vendosim për planin e punës, vendosim për projekte që do zbatohen, diskutojmë strategjitë që duhen ndjekur, vlerësojmë zbatimin e planit të punës, atëherë të gjitha këto ku thuhet misioni dhe objektivat të shtohet një pike, ku të thuhet aktivitetet e MSG-së dhe aty shëno këto tre-katër pika njëri pas tjetrit.

Znj. Çinari: Cilat pika?

Znj. Puka: Këto që janë thënë te konflikti i interesit sepse neve na i bashkangjisni këto që ne po i bëjmë këto dhe bën konflikt interesi ndërkohë detyrat tona që realisht thuhet tek pjesa e konfliktit të interesit nuk janë të përmëndura në këtë rregullore.

Znj. Çinari: Të përcaktoj objektivat e procesit, të punoj për hartimin e politikave dhe treguesit strategjikë.

Znj. Puka: Jo jo, këto këtu. Ne e kemi shumë operative punën, te pjesa e konfliktit të interesit.

Z. Hasanlami: Te faqja 10.

Znj. Puka: Te faqja 13 MSG është shumë operative, vendos për planin e punës EITI, vendos për projektet që do të zbatohen.

Znj. Çinari: Po e ke të përsëritur këtë që po kërkon.

Znj. Puka: Dakort, por është më mirë të thuhet copy-paste siç janë këtu, plani vjetor i punës se ne këto gjëra bëjmë.

Znj. Çinari: Kjo është më mirë, kjo ju duket më mirë?

Znj. Puka: Po, të jenë aktivitetet e MSG-së dhe ajo le të rrij se janë objektiva edhe të gjitha këto që thotë profesori zgjidhen.

Z. Alikaj: Unë nuk kam parasysh ndonjë gjë të veçantë por dua të them edhe problemi financiar i kësaj EITI-t duhet të marrë një ..diku të shkruajtur,kaq.

Znj. Çinari: Unë nuk kam asnjë problem fare ne mund t'i publikojmë edhe tek faqja jonë, bile i kemi edhe të publikuara.

Z. Alikaj: E di, po të jetë se si do operohet se është një Rregullore.

Znj. Çinari: Por nuk ka MSG-ja në tagër të kontrolloj financat, nuk është në tagrin e saj, ka tagër politikat, janë dy gjëra të ndryshme, nëse doni ta shtoni e shtojmë.

Z. Alikaj: A është organizatë që hyjnë dhe dalin paratë këtu?

Znj. Çinari: Mua më kontrollojnë 7 organizma të ndryshme.

Z. Alikaj: Dakort por duhet shkruar.

Znj. Puka: Jo kontroll por shpërndarje informacioni.

Znj. Çinari: Po çfarë doni, formuloheni po ju them.

Znj. Puka: Po a kemi pjesën e vlerësimit të planit të punës tuaj, çfarë kuptojmë me fjalën vlerësimi i planit të punës EITI, ma thuaj.

Znj. Çinari: Ekzekutimi i aktivitetit.

Znj. Puka: Jo çfarë mendoni juve, ato na vini në dispozicion se ne s' do merremi me gjëra të vogla, se ska kuptim.

Z. Alikaj: Ju jeni në atë të përditshmen.

Znj. Puka: Se dhe ne skemi kohë të merremi me çdo lek që disburson Sekretariati se nuk është as targeti jonë kjo gjë.

Z. Alikaj: Dakort por dhe ju deri diku do të bëni raportim.

Z. Hasanlami: Puka, thotë këtë Dorina, duke qënë se MSG-ja vendos për planin e punës dhe projektet që do zbatohen (lexon nën zë), dhe ne shtojmë vetëm këtë duke qënë se MSG-ja vendos për planin e punës dhe vendos për projektet që do të zbatohen, strategjinë që duhet ndjekur dhe vlerëson zbatimin e tij.

Znj. Puka: Një fjali kaq.

Z. Hasanlami: Shtojeni këtë gjë. Çfarë thua për dietat Ilir?

Z. Aliaj: Është kjo pra se ne le të themi Madlina vjen se ka mundësi të vijë dhe le të themi e ka objektiv të saj të vijë në MSG ose sa herë që ka mundësi. Por kemi punonjës që janë në sindikata, që janë në Kukës, Has, Bulqizë në Burrel, që nuk kanë mundësi të vijnë për arsye financiare dhe nëse ti e lë, se nesër edhe Madlina mund ta ketë këtë problem. Nëse ne e lëmë pa i dhënë atij minimalisht pagesën e transportit, ne do e mbyllim këtë çështje vetëm në Tiranë. Dhe në Tiranë ju e dini më mirë se unë që nuk ka as naftë, as gaz, asgjë. Prandaj duhet bërë një përpjekje, ne dhe me Dorinën kemi folur dhe unë e di që ajo më ka thënë disa herë që nuk ka mundësi financiare, por duhet bërë një përpjekje sado e vogël.

Znj. Çinari: Unë i kam ezauruar të gjitha opsionet e mia, jeni të lirë të negocioni dhe ju si antar të MSG-së, mund të bëni kontaktet tuaja dhe ndoshta gjeni zgjidhjen.

Z. Aliaj: Të lutem, ne nuk duhet ta vendosim këtu taksative sepse në raste të tilla.

Z. Hasanlami: Iliri thotë të mos e shkruajmë fare.

Znj. Çinari: Jo duhet ta shkruajmë është detyrim.

Z. Aliaj: Po mire, gjejmë një mënyrë tjetër formulimi.

Znj. Çinari: Jo, MSG-ja duhet të përcaktojë politikën e honorareve dhe dietat.

Z. Aliaj: Po mirë gjejmë një mënyrë tjetër, sepse këtu është shkruajtur nuk ka politikë për ndarjen e honorareve.

Znj. Hajnaj:edhe MSG-ja dhe merrni dhe dieta.

Znj. Çinari: Po.

Znj. Hajnaj: Ne nëse do mundemi, mirë është që të përcaktojmë që këta që do vinë nga larg, ose dietat ose transportin ..

Znj. Çinari: Po nga t'ia jap mi Anila?

Znj. Hajnaj: E kuptoj, se edhe dietat e qeverisë që janë edhe me fjetje janë 5 000 lekë në ditë (të reja).

Znj. Çinari: Jo s'janë, janë 25000 (të vjetra).

Znj. Hajnaj: Edhe me fjetje?

Znj. Çinari: 24 orë..

Znj. Çinari: Ka ndryshuar vendimi i qeverisë është..

Znj. Puka: Ilir të bëj një pyetje, këtu asnjë nuk është nga rrethi, përveç Bakiut, që s'ka ardhur dhe unë që jam personi këtu që duhet të flas dhe ju gjithmonë flisni në emrin tim.

Z. Aliaj: Po fol.

Znj. Puka: Unë personalisht nuk e kam problemin e transportit për të ardhur këtu, po në ato pikat e performances është që ne duhet të bëjmë outreach dhe komunikim nga zonat ku duhet të

vemi dhe unë e shoh më të vështirë për ju, që do jeni nga Tirana, që duhet të shkoni në Bulqizë që të bëni komunikim dhe outreach, se sa lekët e Bakiut për të ardhur këtu.

Z. Aliaj: E ke gabim, do marrim projekt.

Znj. Puka: Kështu që shikoji pak gjërat më gjërë se sa një biletë transporti.

Z. Aliaj: E ke gabim shumë gabim, sepse ai është minator. Me fal sa merr një minator, të lutem afërsisht?

Z. Hasanlami:600 mijë lekë.

Znj. Çinari: MSG-ja duhet të përfaqësohet nga persona që kanë kapacitetin për të marrë pjesë, është e shkruar në Standart, kapacitetin dhe vullnetin për të marrë pjesë.

Z. Aliaj: Që ta mbyllim, unë them që duhet ta formulojmë pak ndryshe.

Znj. Çinari: Propozim ju lutem!

Z. Aliaj: Tani e doni propozimin, a mund ta sjell pak më vonë?

Znj. Çinari: Po. Ka dy javë ky dokumenti që e kemi shpërndarë, kemi marrë shumë shënime.

Z. Hasanlami:Shumica u mbyllën.

(Flasin disa persona në të njëjtën kohë)

Z. Neza: Iliri ka thënë që po shoh një mundësi se si mund të ..kryetari MSG-së

Znj. Çinari: E kemi ezauruar këtë.

Z. Spahiu: Ta themi ndryshe, unë do kërkoja të kemi më shumë angazhim nga Sekretariati për shkak të kohës që ka edhe ekspertizës që të gjejë mundësinë, unë jam dakort siç është shkruar kështu, për mua nuk duhet të ndryshojë, por të gjejë mundësi të tjera.

Z. Arapi: Ato që ndryshuam, do i ndryshojmë ne.

Z. Hasanlami:Thotë për këtë të fundit.

Z. Spahiu: Them për këtë të fundit.

(Flasin disa veta në të njëjtën kohë)

Z. Arapi: Unë kam diçka tjetër, nëse nga eksperiencia e shteteve të tjera, antare të MSG-së ka ndonjë benefit..

(Flasin disa persona në të njëjtën kohë)

Znj. Çinari: Ne jemi buxhetor.

Z. Arapi: Nuk ka lidhje ajo punë, X është parlamentar, merr pjesë në komisione dhe merr honorare.

Znj. Çinari: Po është e parashikuar me ligj.

Znj. Puka: Shoqëria civile është e pavarur nga shteti. T'i kërkojmë lekë shtetit ne, që të vij unë nga Vlora.

Z. Arapi: Ti po jep kontributin e ke gabim, ti po jep kontributin në këtë sallë.

Znj. Puka: Po se kam problem fare po të them.

Z. Arapi: Sa orë ke ti këtu?

Znj. Puka: Eshtë për të tërë ajo nuk është vetëm për ne.

Z. Hasanlami:E di çfarë thotë kjo Azbiu, që nesër ILKPD vjen më kontrollon mua, ti ke qënë anëtar i një bordi, po honoraret, dhe tregon, urdhëro rregulloren i thua ti dhe e mbyll hesapin.

Znj. Puka: ..që të jetë me zero dhe të jetë vullnetare.

Znj. Hajnaj: Kontributi është vullnetar.

Z. Arapi: Neve të lëmë hapsirë, Sekretariati, MSG-ja do bëjnë përpjekje të vazhdueshme me buxhetin e shtetit për diçka simbolike për këtë komision..

Z. Hasanlami:Azbi komisioni o të marrë tamam ose mos të marrë asnjë. Iliri ka edhe një gjë që është shkruajtur mbrapa këtu pika 18, çështja e Sekretariatit.

Znj. Çinari: Çfarë propozimi ka?

Z. Hasanlami:Që nuk është prekur fare çështja ...e Sekretariatit

Z. Aliaj: Ankesat ka edhe atë pikën.

Znj. Çinari: Sekretariati është një institucion që rregullohet me VKM dhe e keni të shkruar komplet aty se çfarë bën Sekretariati.

Z. Hasanlami:Nuk është prekur fare mënyra e adresimit të ankesave.

Z. Aliaj: Po.

Znj. Çinari: Ne e trajtuam në tavolinë.

Znj. Puka: Ankesat e antarëve të MSG-së?

Z. Aliaj: Po ta shkruajmë.

Znj. Çinari: Ankesë apo pakënaqësira?

Z. Aliaj: Ankesë.

Znj. Çinari: Ankesë për çfarë?

Z. Aliaj: Po ku ta di unë se për çfarë mund të dali një ankesë?

(Flasin disa persona në të njëjtën kohë)

Znj. Çinari: Kujt do ia drejtoj dhe kush do ta kthejë përgjigjen?

Z. Aliaj: Pikërisht unë këtë po të kërkoj.

Znj. Çinari: Të lutem listo ti një listë... që thua ti të ankesave.

Z. Aliaj: Po, që në rast që mungon zoti Bejtja, përshëmbull të mos jesh ti Drejtuese e seances.

Znj. Çinari: Po kjo nuk është ankesë.

Z. Aliaj: Prisni ta mbaroj, s'kam mbaruar.

Znj. Çinari: Kjo nuk është ankesë.

Z. Aliaj: Do më lësh të mbaroj apo do e bëni ju ankesën në vëndin tim?

Znj. Çinari: Ilir të lutem herë tjetër ose flit më me etikë në këtë tavolinë ose..

Z. Aliaj: Ku e sheh pa etikën ti?

Znj. Çinari: Të gjitha këto që ke thënë i kemi të inçizuara dhe do ta dëgjoni veten, të lutem. Të lutem fol në përputhje me atë rol që ke në tavolinë.

Z. Hasanlami:Nuk ja vlen të diskutoni tani këtu, nuk po ndahen pronat.

Znj. Çinari: Ankesë për çfarë?

Z. Hasanlami:Dy rrjeshta mund t'i shkruajmë. Dikush mund të ketë një ankesë përshëmbull me kohë zgjatjen e mbledhjes. Ankesat për antarët e MSG-së mund të bëhen në mbledhje të MSG-së ose diçka e tillë dhe ti trajtojmë në mbledhjen e MSG-së.

(Flasin disa persona në të njëjtën kohë)

Z. Neza: Po ankesat të drejtohen në mbledhje të MSG-së.

Z. Aliaj: A ka ndonjë gjë të keqe këtu?

Z. Hasanlami:Nuk ka. Ilir, ankesat mund të bëhen me shkrim ose me gojë, prezent gjatë mbledhjes së MSG-së dhe të trajtohen në mbledhje.

Znj. Çinari: Bashkarisht

Z. Hasanlami:Po bashkarisht. Tani e mbyllim!

Mbyllet mbledhja!